




Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenin 5.1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 37 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, dhe nenit 25.1 të Rregullores së punës të Kuvendit të Komunës së Podujevës,

THËRRAS

Mbledhjen e LII-të (pesëdhjetedy - mandati VII)-e rregullt, të Kuvendit të Komunës së Podujevës, e cila do të mbahet më **18 prill 2025, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në Komunën e Podujevës, në orën 10:00**, dhe propozoj këtë;

Dhënia e Betimit nga anëtarja e Kuvendit të Komunës së Podujevës znj.Donjetë Baliu, (e emëruar me Vendimin e KQZ nr.01/757-2025 datë 21.03.2025)

REND TË DITËS

1. Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më: **05.03.2025** dhe **13.03.2025**
2. Propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2024 në vitin 2025 dhe destinimin në kategori dhe programe të caktuara buxhetore
3. Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti "Furnizim për projektin e shpezëtarisë"
4. Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti "Furnizim për pemëtari"
5. Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti "Furnizim me pajisje për bletë"
6. Raporti vjetor financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024
7. Raporti financiar për periudhën janar-mars 2025
8. Propozim vendimi për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme publike komunale, me pronën e paluajtshme në pronësi të Ismet (Muharrem) Bulliqi
9. Propozim vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa (emërimi i anëtares së Komitetit për Politikë dhe Financa, në vend të znj.Drita Pajaziti e cila ka dhënë dorëheqje nga funksioni anëtare e Kuvendit të Komunës).
10. Të Ndryshme

Nr.Prot.01-060/01-0019676/25
Podujevë, datë; 07 prill 2025





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

**Procesverbal i mbajtur më 05 mars 2025, në mbledhjen Solemne të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VII,
E mbajtur për nderë të shënimit të 27 vjetorit të “Epopesë së UÇK-së”**

Mbledhja filloi në orën 10:10, dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.

Në mbledhje të pranishëm ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

Nga LVV, prezent ishin: Florent Hasani; Fitim Muçolli; Artrit Mulliqi; Sebastina Vokri; Qëndresë Hajrizi; Ragip Fetahu; Xhevdet Maloku; Haki Rudari; Bahri Blakçori.

Nga LDK, prezent ishin: Valon Demolli; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani.

Nga PDK, prezent ishte: Mimoza Abdullahu.

Nga AAK, prezent ishin: Mrika Thaçi; Arbnor Fazliu.

I pavarur, Demokrat Hodolli

Gjithashtu të pranishëm ishin znj.Marigona Lahu Nënkyetare e Komunës, drejtorët e Drejtorive të Komunës, dhe atë;

(Valbona Azemi-Drejtorja e Administratës DA; Avni Fetahu-Drejtorja e Arsimit DKA; Adelinë Stublla-Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Liridon Gashi-Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM; Saranda Stublla-Drejtorja e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Vlera Humolli Jashanica-Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS, Bahri Selimi-Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSh; Shuajb Blakçori-Drejtorja e Inspeksionit DI; Lirie Hoti-Drejtorja e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR, Vigan Salihu-Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE,)

Të pranishëm tjerë ishin; përfaqësues nga Shoqatat e Dala nga Lufta e UÇK-së; z.Muhamet Latifi, z.Florim Statovci, z.Shefki Sejdiu, z.Xhemshiti Gashi, ish komandant i UÇK-së në Zonën Operative të Llapit z.Arif Muçolli, z.Naim Zhitia vëllau i Heroit Afrim Zhitia, z.Idriz Bilalli Imam i Xhamisë Met Podjeva në Qytet, z.Bashkim Bajrami Komandant i Stacionit të Policisë në Podujevë, përfaqësues të mediave lokale-TV Llapi dhe Televizionit Shtetëror RTK, si dhe një numër i zyrtarëve komunale.

Mbledhja u hap me Intonimin e Himnit të Republikës së Kosovës dhe Himnit të Republikës së Shqipërisë – Himni Kombëtar

• Fjalë rasti nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

z.Hilmi Hoxha, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit, theksoi, mirë se keni ardh në këtë mbledhje Solemne kushtuar Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës UÇK. E nderuara zonja Nënkyetare e Komunës Marigona Lahu, të nderuar anëtarë/e të Kuvendit të Komunës, drejtorët e Drejtorive të Komunës, të respektuara Familje të Dëshmorëve, Shoqata të dala nga Lufta, i respektuari dhe shumë i nderuar Komandant i Stacionit të Policisë z.Bashkim Bajrami, i nderuar zotëri Muhamet Latifi, të nderuar zotëri Xhemshiti Gashi, zotëri Shefki Sejdiu, zotëri Florim Statovci,

po ashtu përshëndetje shkonë edhe për Hoxhen z.Idiz Bilalli, të nderuarin profesor dhe komandant lufte zotëri Arif Muqolli, përfaqësuesin e Familjes së Heroit Afrim Zhitia zotëri Naim Zhitia, si dhe të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje, në nderim të të gjithë të rënëve për Lirinë dhe Pavarësinë e Kosovës, ju ftoj për 1 minutë nderim.

*Mbahet 1 minutë heshtje në nderim të të gjithë të rënëve për Lirinë dhe Pavarësinë e Kosovës.
Lavdi*

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, Epopeja e UÇK-së është simbol i qëndresës dhe sakrificës për liri. Epopeja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës UÇK është një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e Kosovës e cila shënoj heroizmin dhe sakrificën sublime të luftës të Shqiptarëve në betejën kundër forcave serbe për liri dhe Pavarësi.

Me 5, 6 dhe 7 mars të vitit 1998, në fshatin Prekaz të Drenicës Familja Jashari e udhëhequr nga Komandanti Legjendar Adem Jashari u përball me një sulm të ashpër nga forcat serbe, në këtë betejë të pabarabartë, Adem Jashari dhe mbi 50 anëtarë të familjes duke përfshirë gra, fëmijë dhe të moshuar ranë heroikisht për të mbrojtur idealin e lirisë.

Epopeja e UÇK-së nuk ishte vetëm një akt heroizmi i një familje por një thirrje për të gjithë Shqiptarët që të bashkohemi në luftën për çlirimin e Kosovës.

Gjakimi dhe qëndresa e Familjes Jashari u bënë simbol i sakrificës Kombëtare duke frymëzuar mijëra të rinj të rrokun armët për të mbrojtur popullin e tyre nga gjenocidi dhe shtypja serbe.

Sot Epopeja e UÇK-së përkujtohet për çdo vit si një moment krenarie dhe reflektimi për sakrificat e bëra në rrugën e pavarësisë. Ajo mbetet një dëshmi e guximit të një populli që nuk u gjunjëzua para shtypjes por që luftoj me vendosmëri për një të ardhme të lirë dhe sovranë.

Si Kryesues i Kuvendit të Komunës së Podujevës, unë e ndjej si një nderë dhe përgjegjësi të madhe që të kontribuojmë për ndërtimin e një të ardhme më të mirë për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Ne si pasardhës të atyre që luftuan, kemi për detyrë që t'i mbrojmë vlerat për të cilat ata dhanë jetën, kjo është një përgjegjësi që e bartim me krenari por dhe një angazhim të vazhdueshëm.

Përfundimisht sot është një ditë për të reflektuar, për të nderuar dhe për të premtuar se do të vazhdojmë të punojmë për një të ardhme më të ndritur si pasardhës të atyre që luftuan për të na e dhuruar lirinë që sot e gëzojmë.

Lavdi dhe nderim për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Kujtimi për ata që ranë do të jetë përgjithmonë në zemrat e popullit të Kosovës.

Ju faleminderit.

Tani ftoj për një fjalë rasti Nënkryetaren e Komunës së Podujevës zonjën Marigona Lahu.

- **Fjalë rasti nga Kryetari i Komunës së Podujevës**

znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës së Podujevës, theksoi, të nderuara Familje të Dëshmorëve, të respektuar përfaqësues të Shoqatave të Luftës, Veteranë dhe Invalidë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, të nderuar drejtorë komunal, mysafirë të nderuar, zonja dhe zotërinj.

Jemi mbledhur sot në këtë seancë solemne për të përkujtuar një nga ngjarjet më të lavdishme të historisë sonë - Epopenë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila përjetësoi sakrificën, heroizmin dhe qëndresën e popullit tonë në përpjekjen e tij shekullore për liri dhe pavarësi.

Data 5, 6 dhe 7 mars 1998 shënojnë ditët kur Familja Jashari në Prekaz, me Komandantin Legjendar Adem Jashari në krye, qëndroi e pathyeshme përballë një makinerie shtypëse dhe barbare, duke vulosur përgjithmonë rrugën tonë drejt lirisë dhe pavarësisë.

Kjo Epope nuk ishte vetëm një betejë, por një akt i jashtëzakonshëm i vetëflijimit për një ideal të lartë, çlirimin e atdheut nga pushtimi dhe shtypja.

Sot, ndërsa përulemi me nderim dhe krenari përpara sakrificës së Dëshmorëve, na takon të reflektojmë mbi përgjegjësinë që mbajmë për ta çuar përpara idealin e tyre.

Ata dhanë jetën për Kosovën e lirë e të pavarur, një Kosovë ku brezat e ardhshëm të jetojnë me dinjitet, me arsim cilësor dhe mirëqenie, në një Shtet ku sundon ligji dhe ku çdo qytetarë ndjen frymën e barazisë dhe drejtësisë.

Sot, ne e kemi për detyrë që vlerat e luftës së Ushtrisë Çlirimtare t'i mbrojmë dhe t'i kultivojmë.

Epopeja e UÇK-së nuk është thjesht një kujtim historik, por një testament i përhershëm për të gjithë ne që të mos ndalemi në rrugën e forcimit të shtetit dhe zhvillimit të vendit tonë. Prandaj, angazhimi ynë për të ndërtuar institucione të forta dhe për të mbajtur gjallë frymën e sakrificës për të mirën e përbashkët duhet të jetë i palëkundur.

Të nderuar të pranishëm, në këtë përvjetor të lavdisë, le ta kujtojmë Epopenë e UÇK-së me krenari, le të punojmë çdo ditë për një Kosovë më të drejtë, më të zhvilluar dhe më të fortë. Ky është amaneti i Dëshmorëve, ky është premtimi që duhet t'i japim brezave të ardhshëm.

Lavdi e përjetshme Dëshmorëve të Kombit.

Lavdi Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ju faleminderit.

Kryesuesi i Kuvendit, duke falënderuar parafolësen Nënkryetare e Komunës, theksoi, ftojme për një fjalë rasti ish Komandantin në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës në Zonën Operative të Llapit zotëri Muhamet Latifi

• Fjalë rasti e përfaqësuesit të Shoqatave të dala nga Lufta e UÇK-së

z.Muhamet Latifi, ish Komandant në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës-Zona Operative e Llapit, në emër të Shoqatave të Dala nga Lufta e UÇK-së, theksoi, fillimisht falënderoj Kryesuesin e Kuvendit për fjalën e dhënë edhe pse t'ju them të drejtën nuk e dija që do të më jepet fjala. Ndihej i nderuar që jam në mesin tuaj dhe në këtë sallë për herë të parë tani po hyjë, e cila tash më siç më informuan ka rreth 5 vite që është sallë e Kuvendit të Komunës.

Ju përshëndes të gjithëve, Familjarë të Dëshmorëve, Kryetarin e Familjeve të Dëshmorëve i cili përfaqëson këtu, ish Komandantin e nderuar në UÇK të ZOLL z.Arif Muqolli, Hoxhën e nderuar z.Idriz Bilalli të cilin e kemi prijës të mirë, shok dhe mik të mirë me të cilin kemi punuar në faza dhe rrethana edhe të tjera, pastaj përshëndes z.Naim Zhitia shok, mik dhe familjar i Heroit tonë Kombëtar Afrim Zhitia, Komandantin e Stacionit të Policisë në Podujevë i cili kujdeset për mirëqenien tonë të përgjithshme, të gjithë drejtorët e Drejtorive të Komunës që janë prezent këtu, asambleistët prezent dhe të gjithë të pranishmit tjerë.

Sot kujtojmë një ditë shumë të rëndësishme, një ditë të rëndësishme-Epopenë e UÇK-së dhe tërë luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Është mesazhi më sublim për Shqiptarët por edhe për ndërgjegjen Kombëtare, është mesazhi kryesor sepse Komandanti legjendar Adem Jashari, familja Jashari dhe lufta në Prekaz ishte mesazhi kryesor për të cilin në një vend dhe një komb kur i mungon liria, atëherë jeta nuk ka kuptim, dhe kjo Epope e vrau harresën historike, po e them se Epopeja e Prekazit e ka vrarë harresën historike. Ne Shqiptarët besoj se e pranojmë dhe jemi të squar që kemi harruar histori shpeshherë në të kaluarën, mirëpo kjo luftë dhe kjo Epope e ka vrarë këtë harresë dhe a dini pse e ka vrarë, sepse Ushtria e Çlirimtare e Kosovës e ka fituar luftën, e ka fituar luftën dhe e ka përzu armikun shekullor që e kemi pasë këtu, dhe përveç asaj që e ka fituar luftën ne shpeshherë themi së e fitoi luftën me aleatët, krenari është kur i ke miqtë në krah për lirinë e vendit tënd, e që fatkeqësisht ne në histori nuk kemi pasë dhe shpesh ankohejmë që nuk kemi pasë miq sepse të tjerët i kanë përvetësuar miqtë, dhe kjo është poenta kryesore që me luftën e UÇK-së, kjo luftë përvetësoj botën demokratike, ndërgjegjen Kombëtare dhe u fitua lufta.

Kjo është kujtesa historike e jona, ndihemi mirë dhe duhet të ndihemi mirë, por duhet ta ngrisim përgjegjësinë kur kemi parasysh fazat dhe rrethanat në të cilat ka kaluar vendi dhe populli ynë gjeneratë pas gjenerate andaj edhe obligimi ngritët në katorë ne për të qenë të ndërgjegjshëm në punën tonë që e bëjmë, dhe për të punuar për vendin tonë dhe për Komunën tonë.

E përmenda në fillim që këtu në mesin tonë kemi një mik shumë të rëndësishëm dhe një veprimtarë shumë të rëndësishëm që është Hoxhë Idriz Bilalli, pra po e përmend sepse ishim në një rast në Zyrë këtu në Podujevë dhe hynë falangat pushtuese duke na ndërhyrë në mbledhje, dhe njëri prej tyre që e quante veten si komandant i policisë u ul në karrigen e shprazët të Kryetarit të Degës që e kishim në atë kohë zotëri Ilaz Pireva, dhe në atë kohë Nënkyetar ishte Babai i Zonjës parafolëse që tani është Nënkyetare e Komunës këtu, i cili më thot kam me vete 200 marka gjermane dhe po i lë diku që të paktën të mos mi gjejnë dhe të mi marrin edhe ato 200 marka gjermane që kam, por kur erdhi në zyrë, atij i thuhet që të ulet diku tjetër sespe ta kam zënë vendin, por i nderuari z.Ali Lahu i thotë që vendin tim nuk mund ta zësh, dhe ulet në karrigen e vet që kishte aty. Ai (komandanti i policisë) tani po na e kërkon rendin e ditës dhe ne po i thonim që për rendin e ditës jemi në pritje të Kryetarit të Degës, Kryetarin e kishin arrestuar, madje kishin arrestuar edhe disa anëtarë të tjerë që kanë qenë duke ardhur në mbledhje, dhe mes tjerash po thotë ai që po e quante veten komandant i policisë, në fakt i milicisë së asaj kohe, a e keni dënuar ju rastin që ishte vrarë një pushtues asaj dite, dhe njëri prej tyre që ishte aty Hakif Sheholli i përgjigjet që ne nuk jemi gjykatë këtu dhe këto gjëra shkojnë përmes gjykatave, kurse ne këtu zhvillojmë veprimtari politike, por jo për të dënuar këtu.

Prandaj dua të them që kanë qenë rrethana të rënda dhe nuk po dëshiroj të hyjë më tutje sepse atë ditë ka pasë të arrestuar, të maltretuar, kishte të marrë peng dhe gjitha të tjerat, mirëpo lufta e fundit, përpjekjet e pareshtura brez pas brezi, ato u sublimuan me luftën e fundit të Ushtrisë çlirimtare të Kosovës, dhe edhe njëherë po e them se kjo luftë e vrau dhe e varrosi kujtesën historike dhe duhet të jetë përjetësisht në kujtesën e Kombit Shqiptarë dhe të tjerëve sepse luftën e fituam me përpjekje dhe sakrificë të madhe.

Unë edhe njëherë ju falënderoj shumë, dhe ju uroj punë të mbarë dhe suksese në punën tuaj, si dhe duke ju falënderuar që më dhatë fjalën duke i'u drejtuar nga kjo foltore.

Kryesuesi i Kuvendit, duke falënderuar parafolësin për fjalimin, ftoi për të marrë fjalën përfaqësues tjerë të UÇK-së siç ishte z.Arif Muçolli ish Komandant në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës-Zona Operative e Llapit, mirëpo meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për të marrë, duke i falënderuar të gjithë për pjesëmarrje në këtë mbledhje solemne, dhe duke i'u dëshiruar që ditë të tilla të festohen e shënohen edhe për shumë vite në mesin e Komandantëve dhe luftëtarëve të UÇK-së dhe popullit të Kosovës, e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 10:30

Procesverbalin e mbajti;
Enis Sheholli

Nr.Prot.01-060/04-0013624/25
Podujevë, 05 mars 2025

Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal nga mbledhja e LI-të (pesëdhjetenjë)-e rregullt, mandati VII-të, e mbajtur më 13 mars 2025.

Mbledhja filloi në orën 10:20 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.

Në fillimin e mbledhjes të pranishëm ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

Nga LVV, Florent Hasani; Fitim Muçolli; Artrit Mulliqi; Kasib Bashota; Sebastina Vokri; Qëndresë Hajrizi; Ragip Fetahu; Xhevdet Maloku; Ardi Hasani; Haki Rudari; Bahri Blakçori; Lirika Maliqi; kurse mungoi Drita Pajaziti.

(Nga LDK Valon Demolli; Arnisa Sylejmani; Arjant Topanica; Donjetë Sheqiri; Ilir Koprani; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Tringa Sfishta; Fahri Hasani; Qendresa Haliti; Fatmir Gashi; kurse mungoi Edona Shabani.

Nga PDK, Bashkim Sylja; Mimoza Abdullahu, kurse në fillim të mbledhjes mungoi Endritë Murati

Nga AAK, Mrika Thaçi; Burim Hasani; Arbnor Fazliu.

Nga OBKD, Gazmend Islami i cili mungoi.

Të pavarur, Adnan Zymeri, kurse mungoi Demokrat Hodolli.

Gjithashtu të pranishëm nga Ekzekutivi i Komunës ishin, znj.Marigona Lahu Nënkrjetare e Komunës, drejtorët e Drejtorive të Komunës;

(Valbona Azemi-Drejtorja e Administratës DA; Fatlum Osmani-Drejtorja e Buxhetit dhe Financave DBF; Avni Fetahu-Drejtorja e Arsimit DKA; Adelinë Stublla-Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Saranda Stublla-Drejtorja e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Vlera Jashanica-Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS; Bahri Selimi-Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtës dhe Shpëtimit DSHPMSh; Lirie Hoti-Drejtorja e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR; Vigan Salihu-Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE;)

Të pranishëm ishin edhe, Kovacs Karoly përfaqësues i KFOR-LMT; Samir Calakovic nga OSBE; media lokale (TV Llapi) dhe disa zyrtar komunal.

Rendi i Ditës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit dhe duke i'u dëshiruar mirëseardhje dhe punë të mbarë, konstatoi kuorumin ku prezent për momentin ishin 26 anëtar/e të Kuvendit të Komunës, kurse për momentin në fillim të kësaj seance mungojnë 9 anëtarë/e, theksoi, pra mungesat janë të shumta.

Po fillojmë me mbledhjen, para se të fillojmë me votimin për rend të ditës sipas thirrjes së mbledhjes, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën.

znj.Adelinë Stublla, drejtoresh e DSHMS, theksoi, propozoj propozim vendimin për kompensim të anëtarëve të komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” që të hyjë si pikë e rendit të ditës, si dhe propozimin e dytë që është propozim vendimi për kompensimin e aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Llapi”.

Pra propozoj që këto dy pika të rendit të ditës të hyjnë në këtë seancë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, pra kemi dy propozime të reja dhe menjëherë i hedhim në votim që të hyjnë si pika shtesë në rend të ditës në këtë mbledhje.

Propozimet e tilla hedhen në votim menjëherë, ndërsa për rend të ditës mund ta merrni fjalën pastaj kush do që dëshiron.

z.Naim Çunaku, duke i reaguuar Kryesuesit që njëherë jepen të gjitha propozimet për rend të ditës e pastaj hedhen në votim një nga një. Në vazhdim theksoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit, kur po fillojnë mbledhjet dhe po jemi tek rendi i ditës nuk e di a qëllimisht apo nuk po e di përse kjo kështu kur është rendi i ditës në pyetje ne të gjithë kemi të drejtë të propozojmë për rend të ditës, dhe pasi ti marrësh propozimet për rend të ditës atëherë mund të kalojmë në votim.

Në vazhden e kësaj, më bëri të marrë fjalën propozimi i parafolësës zonja Adelina Stublla, dhe këtu përse po kemi nevojë të krijojmë një mjegull, huti apo qysh duash ta quajmë, për faktin që nëse ajo pikë e rendit të ditës për kompensimin e anëtarëve të atyre Ndërmarrjeve Publike Lokale i ka kaluar dy seanca dhe në asnjërën seancë nuk ka marrë epilog, ajo nuk e di përse duhet të propozohet kur në këtë seancë ajo ka qenë dashtë me automatizëm, sepse një mbledhje kur ndërpritet dhe nuk merr epilog të një pike të caktuar të rendit të ditës, atëherë vazhdohet me seancën tjetër për atë pikë të rendit të ditës, pastaj fillon seancë e re, kurse kjo forma qysh po tentohet të bëhet vërtetë është një çoroditje e punës së Kuvendit.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, fillimisht para se të propozoj disa pika për rend të ditës, deshta që ty së pari si Kryesues i Kuvendit t’ju bëjë një pyetje, a din i nderuar Kryesues që ky Kuvend ka një Plan të punës të cilin e kemi aprovuar për vitin 2025, a e din që ti obligohesh për t’ju përmbajtur atij vendimi apo vendimet e këtij Kuvendi ti nuk i përfillë, a i përfillë apo jo.

Kryesuesi i Kuvendit, duke i ndërhyrë parafolësës, theksoi, çka është në pyetje konkretisht.

znj.Donjetë Sheqiri, vazhdoi, konkretisht po foli për atë që ka rreth tre muaj që po kalojmë në vitin 2025 dhe nuk i’u ke përmbajtur as minimalisht Planit të punës së Kuvendit për vitin 2025. Asnjë nga Drejtoritë, përveç Drejtorisë së Bujqësisë që sot vie me raportim, asnjë tjetër nuk ka raportuar në Kuvendin e Komunës ashtu qysh është paraparë, prej kujt janë duke ikë, a e dinë që e kanë për obligim të raportojnë para Kuvendit, a e din ti Kryesues që duhesh t’ju tregosh, fillimisht neve si anëtarë/e të Kuvendit e pastaj edhe qytetarëve pse këta drejtor të drejtorive po i’u ikin raportimit në Kuvend.

Unë propozoj që të gjitha pikat të cilat janë tejkaluar të hyjnë sot në rend të ditës, pra me Plan të punës janë paraparë:

- Plani i prokurimit për vitin 2025 i cili që nga muaji janar nuk ka ardh në Kuvend,
- Informatë nga Drejtoria e Arsimit,
- Informatë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit,
- Informatë nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit,
- Informatë nga Drejtoria e Inspeksionit.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush tjetër dëshiron të marrë fjalën për rend të ditës, nëse jo atëherë i hedhim në votim propozimet e drejtoreshës së DSHMS-së znj.Adelinë Stublla, që dy pikat e propozuara që jenë pjesë e rendit të ditës në këtë mbledhje, pra votojmë ndaras për dy këto pika.

Propozimi i parë ishte propozimi për kompensimin e anëtarëve të komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Llapi” Sh.A Podujevë.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 26 anëtar/e sa ishin prezent në sallë, 15 vota ishin Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur, (të tjerët nuk morën pjesë në votim) mbështetet propozimi për përfshirje në kuadër të rendit të ditës edhe pika shtesë:

-Propozim për marrjen e vendimit për kompensimin e anëtarëve të komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Llapi” Sh.A. në Podujevë.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi duke e hedh në votim propozimin e dytë që ishte për kompensimin e anëtarëve të komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” Sh.A Podujevë.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 26 anëtar/e sa ishin prezent në sallë, 14 vota ishin Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur, (të tjerët nuk morën pjesë në votim) mbështetet propozimi për përfshirje në kuadër të rendit të ditës edhe pika shtesë:

-Propozim për marrjen e vendimit për kompensimin e anëtarëve të komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” Sh.A. në Podujevë.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, pra edhe këto dy pika do të jenë pjesë të rendit të ditës sot në këtë mbledhje, dhe atë si pika të fundit të rendit të ditës.

Tani e hedhim në votim propozimet e znj.Donjetë Sheqiri që pikat e theksuara dhe propozuara nga ajo të përfshihen në kuadër të rendit të ditës sot në këtë mbledhje.

znj.Donjetë Sheqiri, ndërhyrë duke i thënë Kryesuesit që nuk është në rregull ta përsëritësh votimin sa herë që dëshiron ti siç e bëre në këtë rast.

Kryesuesi i Kuvendit, përgjigje parafolëses, theksoi, nuk jam duke e përsëritur por nuk isha në dijeni për z.Haki Rudarin se a e ngriti dorën për ta marrë fjalën apo për të votuar sepse paraprakisht kërkoi fjalën duke e ngritur dorën, këtu ishte problemi, jo diçka tjetër.

Pra ka filluar votimi të nderuar, 10 vota ishin Për, tani kërkohet të votohet kush është kundër, andaj ju lutem urdhëroni votojmë. Po e shoh që z.Haki Rudari po kërkon fjalën vazhdimisht por tani s’mund të kalojmë në debat sepse ka filluar procesi i votimit.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 26 anëtar/e sa ishin prezent në sallë, 10 vota ishin Për, 10 votë Kundër, asnjë votë të Përmbajtur (të tjerët nuk morën pjesë në votim, por duke përdorur votën e dyfishtë të Kryesuesit të Kuvendit në rastet kur votat janë të barabarta, e që ishte votë Kundër në këtë rast), nuk kalon propozimi që pikat e propozuar nga znj.Donjetë Sheqiri të përfshihen si pika shtesë në kuadër të rendit të ditës në këtë mbledhje:

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, unë vlerësova të votoj kundër (përfshirë edhe votën e dyfishtë) për shkak se për gjitha ato pika që u propozuan për tu përfshirë sot në rend të ditës, Kuvendi nuk është i përgatitur dhe se nuk ka materiale t’i trajtoj sot.

znj.Donjetë Sheqiri, ndërhyrë duke theksuar, nuk e di qysh një Kryesues i Kuvendit mund të votoj kundër Planit të punës së Kuvendit të cilin e ke përpiluar vet sepse ke qenë kryetar i ekipës që e keni përpiluar këtë Plan, andaj qysh mund të votosh kundër. Qysh ti si Kryesues i Kuvendit mund të votosh kundër, a mund ta dimë. Pastaj ti vet e ke bërë këtë por tani po thua që nuk mund t’i fusim gjitha këto pika sot, mirëpo përse nuk e ke respektuar Planin e punës dhe t’i sjellës në afate mujore. A nuk po të dëgjojnë drejtorët apo çka është puna, nëse po bëhu burrë përgjigju, thuaje po nuk po më dëgjojnë, nuk po guxojnë të vinë të raportojnë në Kuvend, dhe kaq.

Kryesuesi i Kuvendit, duke i reaguuar parafolëses, theksoi, drejtorët e Drejtorive nuk më japin përgjegjësi mua si Kryesues, por i japin përgjegjësi Kryetarit të Komunës. Përndryshe ne tani nuk jemi duke bërë debat dhe as nuk e kam për obligim të të jap arsye ty e as askujt për këto gjëra.

z.Valon Demolli, theksoi, i nderuar Kryesues, fillimisht këto dy pikate propozuara nga znj.Adelinë Stublla nuk kaluan asnjëra sepse nuk kanë të drejtë që aksionarët të jenë pjesë e votimit, por duhet të dalin jashtë nga salla për të mund të hyjnë në rend të ditës ato pika. Përndryshe kjo çështje nuk kalon kështu në këtë formë sepse nuk kanë të drejtë të votojnë anëtarët e komisioneve përkatëse që janë e që ka dilema se kanë votuar. Pra mund të ketë konflikt të interesit.

Kryesuesi i Kuvendit, i përgjigjet parafolësit, theksoi, besoj se rreth asaj çështje që e ceku parafolësi z.Valon Demolli, në mbledhjen e kaluar të Kuvendit e kam sqaruar për këtë, unë askujt nuk mund t'i them as voto e as mos voto. Unë nuk mund ta largoj nga salla askënd, ata e dinë që ka konflikt të interesit dhe nuk kanë të drejtë të qëndrojnë në sallë.

znj.Donjetë Sheqiri, sërish theksoi, ti si Kryesues i Kuvendit duhet të reagosh duke deklaruar që nuk kaloj ai propozim, a je Kryesues i Kuvendit apo jo, 4 vite po i bën që je Kryesues dhe ende nuk po i din kompetencat tuaja. Ti duhesh t'ju tregosh që këta anëtarët e Kuvendit që janë anëtar të komisioneve të Ndërmarrjeve përkatëse duhet të dalin jashtë dhe nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në votim.

z.Valon Demolli, sërish theksoi, Kryesues, edhe njëherë po të them se ato pika nuk kalojnë, dhe ti duhet t'ju tregosh që është konflikt të interesit sepse nuk kanë të drejtë që ata të cilët janë pjesë e aksionarëve të jenë prezent në sallë dhe në proces të votimit.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi duke i'i përgjigjur parafolësve, nuk jam unë për t'ju treguar atyre si të veprojnë. Unë në mbledhjen e kaluar i'u kam treguar që duhet të dalin nga mbledhja dhe kanë dalë nga mbledhja, sot nuk kanë dalë nga mbledhja, është e drejtë dhe përgjegjësi e tyre e tyre.

z.Valon Demolli, theksoi, i nderuar Kryesues a ta ka kthyer përgjigje MAPL për këtë pjesë.

Nëse nuk e ke kontaktuar, përse nuk po e bënë sepse kur ish çështja për neve në rastin e Komitetit për Komunitete, ti na thojë se duhet pritur vendimi i MAPL-së, ndërsa këta sot e propozuan dhe ju jepet e drejta e propozimit dhe ti thua kanë të drejtë të propozojnë, kurse kur në pyetje për neve thua jo sepse duhet pritur vendimi i MAPL-së.

Pra edhe për këtë kërkoj ta presim vendimin e MAPL-së, sepse neve na thojë ta presim vendimin e MAPL-së pastaj vendosim, ashtu edhe unë po kërkoj sot.

Kryesuesi i Kuvendit, sërish përgjigje parafolësit, theksoi, unë propozimet nuk mund t'ia ndal askujt, askujt nuk i'a kam ndal propozimet.

z.Naim Çunaku, theksoi, vërtetë i nderuar Kryesues, nuk e di dhe nuk po dua ta them që ta gjejë fajtorin por me vet faktin që ti je Kryesues i Kuvendit faji për menaxhimin e seancës bie mbi ju zotëri Kryesues. Tani jemi në një situatë ku a i konsideron ti Kryesues pika të miratuara të rendit të ditës ato pika ku votojnë ata që nuk kanë të drejtë, këtu duhet një sqarim, por ligjërisht kjo nuk mund të kaloj tutje sepse kanë votuar njerëz të cilët nuk kanë të drejtë të votojnë.

Një vendimmarrje ku votojnë ata që nuk kanë të drejtë të votojnë është nul, dhe unë e kam një pyetje tani qysh mendoj ti Kryesues të procedosh tutje seancën kur a e konsideroj të miratuar dhe pjesë të rendit të ditës, apo nuk i konsideron. A konsideron një diçka në kundërshtim me ligjin të miratuar apo nuk e konsideron, pastaj a e konsideron që ajo mbledhja e kaluar ka dashtë të jetë vazhdimësi e për të cilën nuk më jape asnjë përgjigje, apo nuk e konsideron.

A ndihet mirë dikush prej kuvendarëve ta ngrisë dorën, e në veçanti Kryesuesi i Kuvendit që të votoj kundër Planit të punës së Kuvendit. E dim atë gjë që ty Kryesues nuk të japin llogari drejtorët e Drejtorive, janë të Kryetarit të Komunës, por ne jemi llogaridhënës para Planit tonë që e kemi miratuar mu këtu, dhe të ngritën kuvendarët dhe të votojnë kundër Planit të punës të tyre vërtetë mjerim, vërtetë nuk di ku e qon punën e këtij Kuvendi më.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, shikoni, ata të cilët janë aksionar në Ndërmarrjet përkatëse unë në mbledhjen e kaluar ju kam treguar që aksionarët nuk kanë të drejtë marrin pjesë në votim.

Në mbledhjen e kaluar ata kanë dalë prej sallës kurse sot nuk kanë dalë dhe kjo është përgjegjësi e tyre, nuk është përgjegjësi e imja të largoj dikë nga salla.

z.Naim Çunaku, ndërhyjnë duke i kërkuar Kryesuesit që a të debatojmë tani për këtë çështje, a janë futur në rend të ditës apo jo ato dy pika, këtë përgjigje po e kërkojmë.

z.Bashkim Syla, nga vendi theksoi, anëtarët përkatës të komisioneve të Ndërmarrjeve në fjalë vetëm nga salla nuk kanë dalë, por nuk kanë votuar.

(Disa prej anëtarëve të Kuvendit të Komunës reagojnë duke thënë që edhe anëtarët e komisioneve të Ndërmarrjeve përkatëse votuan në atë proces, dhe vazhdojnë duke debatuar dhe kundërshtuar me të tjerët lidhur me këtë proces se kush ka votuar, kush jo, dhe si kanë votuar)

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, nëse anëtarët e komisioneve përkatëse të Ndërmarrjeve në fjalë kanë votuar është përgjegjësi e tyre, kamerat janë dhe dihet se akne votuar apo jo për ato pika dhe si kanë votuar.

z.Haki Rudari, theksoi, vazhdimisht kam theksuar se Kuvendet Komunale udhëhiqen nga një parim ose udhëhiqen nga Ligji për vetëqeverisje lokale, ai lidh nuk bënë dallime për asnjë subjekt politik. Tani po kthehem te rendi i ditës i Komunës tonë dhe është e vërtetë ajo që e ceku znj.Donjetë Sheqiri se ku është miratuar Plani i punës së Kuvendit për vitin 2025 nëse nuk gaboj në muajin dhjetor, unë kam qenë kundër për arsye se nuk është marrë për bazë Rregullorja e cila parasheh që mbledhjet të caktohen edhe me data e që ato data mund të lëvizin vetëm 7 dit, nuk është përkrahur kërkesa ime dhe nuk e kam votuar atë Plan të punës. Prandaj pajtohem me atë që kolegja znj.Donjetë Sheqiri e potencoi se Plani i punës duhet të respektohet, duhet të mësohemi dhe të respektojmë Plane të tilla, madje unë vijë nga fusha e arsimit dhe ata që vijnë nga kjo fushë e dinë këtë që ne kemi një Plan të punës i cili na obligon të zhvillojmë ato njësi mësimore që kemi për t'i shpjeguar, i njëjtë është edhe ky si Plan i punës së Kuvendit dhe këtë shumë sinqerisht e them. Këtë e kam kërkuar sa isha në opozitë dhe njëjtë edhe tani e kërkoj, Plani i punës duhet t'ju shkoj dhe secili duhet ta shoh për vete se në cilin muaj e ka të paraparë për ta informuar Kuvendin e Komunës ngase ai nuk na njofton vetëm neve si LVV por e informon Kuvendin e Komunës të të gjitha subjekteve politike, edhe këtu pajtohem prandaj është mirë të respektohet.

Sa i përket votimit lidhur me pikat e propozuara për kompensimin e anëtarëve të komisioneve të aksionarëve, unë i përcjella këto dhe fundja secili Kuvend Komunal e ka shërbimin profesional, për lka besoj e kolegu z.Naim Çunaku e din këtë sepse ka më shumë përvojë se unë, ose Zyra ligjore duhet të dal me një qëndrim dhe atë qëndrim që e jep për mua si shef i Grupit është e pranueshme, është shkel, s'është ligji.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, sa i përket vazhdimit të mbledhjes së kaluar e cila është ndërprerë në fund për shkak të mungesës së kuorumit e që unë e kam ndërprerë me konstatim që kurdo që krijohen kushtet do të thirret vazhdimi i saj, por nuk ka pas vullnet ngase unë i kam kontaktuar shefat e Grupeve dhe nuk ka pas interesim prej tyre për të vazhduar ajo mbledhje, kjo është e vërteta sepse ajo mbledhje nuk ka përfunduar.

Sot në këtë mbledhje janë sjellë si pika të ndara për të cilat u votua të hyjnë në rend të ditës ku ishin 14 vota Për, që të hyjnë në rend të ditës dhe tani a kanë votuar anëtarët e komisioneve përkatës të aksionarëve këtë t'ju them të drejtën nuk e di, por janë kamerat dhe ka incizime andaj nëse kanë votuar është përgjegjësi e tyre para ligjit, nuk është dhe nuk kanë përgjegjësi para meje si Kryesues. Unë në mbledhjet e kaluara i kam njoftuar ata anëtarë të komisioneve që duhet ta lirojnë sallën ata anëtarë që janë në Ndërmarrjen përkatëse, shembull për NPL "Stacioni i Autobusëve" anëtarët e komisionit të aksionarëve të kësaj Ndërmarrje nuk kanë të drejtë të jenë pjesë e procesit të votimit, pastaj edhe për NPL "Eko-Llapi" e njëjta gjë, por nëse ata kanë votuar mbetet përgjegjësi e tyre, por sërish e theksoj që unë mund t'i shikoj kamerat pastaj dhe të vërtetoj se a kanë votuar apo jo.

z.Naim Çunaku, theksoi, në pjesën dërmuese të diskutimit të kolegut parafolës shef i Grupit të LVV, pajtoj, që Ekzekutivi nuk jep llogari para subjektit politik por jep para Kuvendit të Komunës e që do të më gëzonte një fakt po të ishte ashtu, mirëpo këtu po ndodh e kundërta e që nuk është mirë që po ndodh, por që po ndodh, është shumica dhe nuk mund ta kundërshtoj unë atë pavarësisht mendimit tim ata ecin.

Çështja tjetër zotëri Rudari, deshta të bëjë një sqarim kur e përmendët që Zyra ligjore është autoriteti i cili përcakton rregullat gjegjësisht anën ligjore, dua të jem i qartë edhe para përfaqësuesve të kësaj Zyre, sepse nuk është hera e parë që merremi me këtë duke thënë që është Zyra ligjore, ju them se Zyra ligjore nuk është kompetente për vlerësimin e vendimmarrjes të Kuvendit të Komunës, dhe pikë. Zyra ligjore përgatit dokumentacionin dhe është ndihmëse për punën e Kuvendit por asnjëherë dhe kurrë nuk mundet dhe nuk është autoritet për të shqyrtuar ligjshmërinë e Kuvendit të Komunës, për këtë të jemi të qartë zotëri Rudari.

Vendimet e Kuvendit të Komunës, autoritet për shqyrtimin e ligjshmërisë së tyre është vetëm Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal-MAPL, apo një instancë më e lartë sepse nuk mund të jetë ai që e kontrollon vendimmarrjen e Kuvendit një instancë më e vogël, në këtë rast siç është Zyra ligjore, por kontrolli është gjithmonë një instancë më e lartë, dhe në këtë rast instancë më e lartë është MAPL, të jemi të qartë.

Çka nuk mund të pajtoj z.Haki Rudari, qëllimisht ju përmenda emrin 3 herë, më bërë vërtetë të ndihem keq kur pash që anëtarët e Kuvendit të Komunës nga radhët e LVV-së votojnë kundër Planit të punës së Kuvendit i cili është miratuar në këtë Kuvend, kjo është fundi i demokracisë.

z.Haki Rudari, theksoi, unë vërtetë që i përmenda dy emra dhe nuk ka kurrfarë problemi.

Sa i përket kolegut parafolës dhe nëse është ashtu qysh ky po thotë, përse ne po bëjmë gjithë këtë zhurmë, jo është votuar, jo ka të drejtë, jo s'ka të drejtë, lërja këtë çështje pra MAPL-së, por mos bë zhurmë, mos kukat, lërja MAPL-së që të jap verdiktin përfundimtar.

Çështja tjetër, unë kam përcjellë shumë Kuvende komunale e që në disa raste në Kuvendet Komunale kërkohet asistim, mendim të Zyrës ligjore i nderuar zotëri Naim, këtë e tash unë, nuk e thash që Zyra ligjore mund të thotë shembull, nuk keni të drejtë këtë, mos e bëni këtë, bëjeni atë, sepse fundja atë e kemi ne, por mendimin profesional të Zyrës ligjore shumë Kuvende Komunale e kërkojnë dhe në këtë rast unë kërkova të njëjtën, a është bërë shkelje e ligjit, ata për atë janë aty, a është bërë shkelje e ligjit, nëse është bërë në rregull, janë seancat tjera dhe këto pika mund të futen. Pra kjo është ajo që unë kërkova, prandaj i nderuar Naim unë e di që mendimin përfundimtar e bënë MAPL, por në disa raste inkorporohet edhe Zyra ligjore për ta ndihmuar procesin.

z.Bashkim Sylja, theksoi, sa i përket si procedurë ne ende nuk e kemi miratuar rendin e ditës, përkatësisht pikat e rendit të ditës për këtë seancë, kështu që është e vërtetë që unë nuk votova sa i përket pikës së aksionarëve mirëpo qëndrova në sallë, andaj nëse është, të mos e ulim nivelin kaq poshtë por të përsëritet votimi edhe njëherë për ato dy pika që të hyjnë në rend të ditës ose jo në këtë mbledhje, të dalim ne jashtë anëtarët e komisioneve të aksionarëve nga salla për secilën pikë dhe të mos e lëm keq shembull një asambleistë / një kolegë tonin keq diçka që ndoshta ka mund të jetë çështje teknike.

Po ashtu unë mendoj se nuk është aq shumë çështje e rëndësishme ashtu qysh po bëhet politikë me këtë punë, mirëpo ta kemi parasysh se në të ardhmen nuk dihet se kush do të jetë pjesë e këtyre komisioneve të aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike, pra do të jetë për të gjitha partitë politike, kështu që më duket se nuk është shumë çështje e rëndësishme aq sa po bëhet politikë me të, kështu që meqë ende nuk është miratuar rendi i ditës unë kërkoj që të përsëritet edhe njëherë votimi për dy pikat përkatëse të cilat u propozuan të përfshihen në rend të ditës sot në këtë mbledhje, dhe ata

anëtarë të cilët janë pjesë e atyre komisioneve ta lirojnë sallën në mënyrë që të mos jenë prezent në proces të votimit.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, i nderuar Kryesues jam duke kërkuar disa herë fjalën dhe nuk po jepet kështu që nuk ke të drejtë t'i të mos ma japësh sepse fjalën mua më ka dhënë qytetari, e jo ti të më ndalesh, dhe kur kërkoj për replikë e kam të drejtën që të replikoj.

Kryesuesi i Kuvendit, duke i'u përgjigjur parafolësës theksoi, mos u ngut, pak më ngadalë sepse edhe jemi me Ramazan kështu që mos u ngut sepse nuk je vetëm ti këtu.

znj.Donjetë Sheqiri, vazhdoi, i nderuar Kryesues, është e pesta herë që e ngrisë dorën për të diskutuar dhe ti nuk ma jep fjalën, më anashkalon, fjalën më ka dhënë qytetari andaj ti nuk ke të drejtë të më ndalësh fjalën mua.

Sa i përket pikave që unë propozova të hyjnë si pika shtesë në këtë mbledhje, unë nuk e thash që ti Kryesues e ke për obligim t'i sjellësh drejtorët e Drejtorive me zor, por ti Kryesues e ke për obligim për ta përfillur Planin e punës së Kuvendit, me i propozu pikat, me i përfshi në rend të ditës, me bë propozimin dhe me i sjellë në Kuvend, ndërsa a vinë apo jo drejtorët të raportojnë nuk është problem i juaji por është problem i tyre pastaj dhe i qytetarëve të cilët le t'i vlerësojnë kush janë, kurse sa i përket pikave të propozuara për të hyrë në rend të ditës e që nuk kaluan, fjala është për propozimet për kompensimin e komisioneve të Ndërmarrjeve Publike, unë kërkoj që votimi të përsëritet, pra për të qenë korrekt votimi duhet të përsëritet.

Kryesuesi i Kuvendit, duke i'u përgjigjur parafolësës theksoi, ne nuk mund t'iu dërgojmë asnjëherë anëtarëve të Kuvendit pika të rendit të ditës pa material. Përndryshe të gjithë drejtorët e Drejtorive janë të njoftuar paraprakisht rreth dy javë më herët se kur ka mbledhje, ndërsa a i sjellin apo jo pikat për Kuvend pastaj ajo është punë e tyre.

Shikoni, nuk po e zgjatim më shumë këtë temë por tani e kemi një propozim prej z.Bashkim Sylës që të përsëritet votimi për ato dy pika se a të hyjnë apo jo në rend të ditës për këtë mbledhje, andaj e hedh në votim që të përsëritet votimi.

Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 27 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent në sallë, 13 vota ishin Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur (të tjerët nuk morën pjesë në votim), mbështetet propozimi që për pikat e propozuara nga znj.Adelinë Stublla drejtoresh e DSHMS për përfshirje në kuadër të rendit të ditës në këtë mbledhje, të përsëritet votimi, me arsye të dilemave të krijuara se anëtarët e Komisioneve të Aksionareve të dy Ndërmarrjeve përkatëse Publike Lokale kanë qenë prezent në sallë dhe se ka mundësi të kenë votuar, e që ka elemente të konfliktit të interesit.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, pra propozimi për përsëritje të votimit kaloj dhe tani fillojmë me procesin e votimit duke filluar sipas rendit, fillimisht për propozimin për kompensimin e anëtarëve të komisionit të aksionarëve të Ndërmarrje Publike Lokale “Stacioni i Aksionarëve” Sh.A.

z.Naim Çunaku, theksoi, për këtë propozim për rend të ditës ne Grupi i LDK-së nuk votojmë dhe njëkohësisht e lirojmë sallën.

(Grupi i këshilltarëve të LDK-së lëshon sallën në këtë proces të votimit për këtë propozim për përfshirje në rend të ditës në këtë mbledhje)

Kryesuesi i Kuvendit, kërkoi të konstatohet kuorumi në mënyrë që të vazhdohet ose jo me mbledhje pas lëshimit të sallës nga Grupi i LDK-së dhe jo vetëm.

Meqë në sallë ishin prezent vetëm 15 anëtar/e të Kuvendit të Komunës dhe nuk ka kuorum për vazhdim të punimeve, Kryesuesi i Kuvendit jep pauzë të shkurtër 15 minuta, dhe atë me qëllim të konsultimeve dhe dekodimeve me Grupet e këshilltarëve për vazhdimin e seancës, (ora 10:50)

Pas pauzës, mbledhja vazhdon në ora 11:20.

Vazhdimin e mbledhjes e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.

Të pranishëm në vazhdimin e mbledhjes ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

Nga LVV, Florent Hasani; Fitim Muçolli; Artrit Mulliqi; Kasib Bashota; Sebastina Vokri; Qëndresë Hajrizi; Ragip Fetahu; Xhevdet Maloku; Ardi Hasani; Haki Rudari; Bahri Blakçori; Lirika Maliqi; kurse mungoi Drita Pajaziti.

(Nga LDK Valon Demolli; Arnisa Sylejmani; Arjant Topanica; Donjetë Sheqiri; Ilir Koprani; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Tringa Sfishta; Fahri Hasani; Fatmir Gashi; kurse munguan Edona Shabani; Qendresa Haliti.

Nga PDK, Bashkim Sylja; Endritë Murati; Mimoza Abdullahu,

Nga AAK, Mrika Thaçi; Burim Hasani; Arbnor Fazliu.

Nga OBKD, Gazmend Islami i cili mungoi.

Të pavarur, Adnan Zymeri, kurse mungoi Demokrat Hodolli.

Gjithashtu të pranishëm nga Ekzekutivi i Komunës ishin, znj.Marigona Lahu Nënkryetare e Komunës, drejtorët e Drejtorive të Komunës;

(Valbona Azemi-Drejtorja e Administratës DA; Fatlum Osmani-Drejtorja e Buxhetit dhe Financave DBF; Avni Fetahu-Drejtorja e Arsimit DKA; Adelinë Stublla-Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Saranda Stublla-Drejtorja e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Vlora Jashanica-Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS; Bahri Selimi-Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtës dhe Shpëtimit DSHPMSh; Lirie Hoti-Drejtorja e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR; Vigan Salihu-Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE)

Të pranishëm ishin edhe, Kovacs Karoly përfaqësues i KFOR-LMT; Samir Calakovic nga OSBE; media lokale (TV Llapi) dhe disa zyrtar komunal.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, atëherë vazhdojmë me punë aty ku mbetëm. Në sallë për momentin janë 23 anëtar/e të Kuvendit, kështu që kuorum ka dhe mund të vazhdojmë.

Urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës.

znj.Adelinë Stublla, drejtoresh e DSHMS, theksoi, meqenëse e pamë se si ndodhi pjesa e çështjes së votimit, atëherë propozoj që të tërhiqen pikat e propozuara nga unë në fillim të mbledhjes, për një seancë të radhës.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse edhe ndokush tjetër dëshiron fjalën lidhur me rendin e ditës, nëse jo atëherë e hedh në votim rendin e propozuar të ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar, si dhe rekomandimeve nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 11.03.2025.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 23 anëtar/e të Kuvendit të Komunës sa ishin prezent në sallë, me 13 vota Për, 1 votë Kundër, asnjë votë e Përmbajtur, miratohet rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar, përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 11.03.2025

Rendi i miratuar i ditës:

1. Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më: 11 dhjetor 2024; 30 dhjetor 2024; 29 janar 2025; 17 shkurt 2025.

2. Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Objektivit Çerdhe Publike në fshatin Balloc - Komuna e Podujevës.

3. Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare Ndërmarrjes Publike Kompania Rajonale e Mbeturinave "Pastrimi" Sh.A

4. Propozim Plani i Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSB, për vitin 2025.

5. Informatë e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

6. Të Ndryshme.

**1. Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më:
11 dhjetor 2024; 30 dhjetor 2024; 29 janar 2025; 17 shkurt 2025.**

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, kemi katër procesverbale për të cilat materialet i keni marrë me kohë, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën lidhur me këto procesverbale.

z.Arjant Topanica, theksoi, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës që janë procesverbalet nga katër mbledhjet e kaluara, deshta të ndërlihem me një çështje për të cilën kemi ngritur polemika me Kryesuesin e Kuvendit para dy seancave, e që ka qenë në lidhje me mungesat që i kam unë dhe që i kanë gjithë Grupi i asamblesë në raport me këtë asamble. Për këtë arsye unë i kërkoja që atëherë Kryesuesit të Kuvendit që ta sjellë listën e mungesave për vitin 2024 dhe ai në atë mbledhje më tha që në mbledhjen e radhës do ta sjellë atë dhe do të verifikoj dhe të sheh mungesat e gjithsecilit e në veçanti mungesat e mia ku kryesuesi më është drejtuar se unë kam shumë mungesa, andaj për këtë arsye unë deshta që tani të e dëshmoj të kundërtën.

Në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Podujevës ku janë të publikuara procesverbalet e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës unë kam nxjerrë dhjetë procesverbale që janë të publikuara për vitin 2024, ndërsa duke i'a bashkëngjitur edhe këto 4 procesverbale të kësaj mbledhje, gjithsejtë këtu i kam 14 procesverbale nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura në vitin 2024.

Në të gjitha këto procesverbale, edhe publikisht kamerat mund t'i fokusojnë, ku unë kam qenë prezent në të gjitha këto dhe unë tani po i shpaloj sheqjet e shpejt para kamerave gjitha këto procesverbale, *(i paraqet të shtypura procesverbalet në fjalë-vetëm pjesët ku figuron pjesëmarrja)*, besoj që nuk marrë kohë shumë i nderuar Kryesues por në deklarata duhet të jemi të matur.

Pra tani siç shihet në këto 14 procesverbale nga mbledhjet e mbajtura të Kuvendit në vitin 2024 unë kam qenë prezent në të gjitha këto, kurse edhe njëherë po e potencoj se Kryesuesi i Kuvendit ka bërë konstatim publik se unë paskam shumë mungesa, e për këtë arsye Kryesuesi ose duhet ta tërheq fjalën ose duhet të kërkoj falje sepse ka bërë një konstatim publik dhe është shumë i rëndë, ashtu e konsideroj unë si shumë të rëndë për arsye se jemi të zgjedhur të jemi prezent këtu dhe të jemi mbrojtës të fjalës dhe besimit që na e ka dhënë qytetari, e mos të kemi mungesa, për atë arsye e kam marrë me shumë shqetësim, i'a kam dëshmuar të kundërtën andaj edhe kërkoj edhe njëherë që Kryesuesi ose të kërkoj falje ose ta tërheqë fjalën e vet.

Para qytetarit do të jem gjithherë përgjegjës për atë me çfarë më kanë ngarkuar dhe për çfarë më kanë dhënë besim.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, për mungesa ti i nderuar zotëri Topanica edhe i ke nxjerrë dhe po të besojmë se është ashtu siç potencove. Në qoftëse kam thënë diçka që nuk është ashtu të kërkoj fjale mirëpo edhe tani e them se në pjesët e dyta pas pauzave apo pjesëve të treta shpeshherë keni munguar plot prej juve dhe tani me emra nuk i kemi nxjerrë, prandaj është dashtë ti i nderuar t'i nxjerrësh edhe vazhdimet e mbledhjeve pas pauzave.

Përndryshe edhe njëherë nëse është ashtu siç e deklarove, të kërkoj fjale.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, kërkoj që nëse ka mundësi të ndahen procesverbalet në proces të votimit. Shembull, në seancën e 17 shkurtit, ne Grupi i LDK-ës kemi ardhur në sallë, por kemi dalë menjëherë jashtë meqë në sallë kanë qenë vetëm 3-4 persona, dhe pastaj nuk kemi qenë pjesëmarrës në atë mbledhje, kështu që në një seancë që nuk kemi qenë prezent si të votojmë procesverbalin ngase nuk e di se çfarë keni folë sepse nuk është transmetuar as drejtpërdrejtë, prandaj kërkoj që nëse do të kishte mundësi që procesverbalet të ndahen dhe të votohet ndaras për secilin veç e veç, mirë do të ishte.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, nëse jo atëherë vazhdojmë me procesin e votimit duke i hedh në votim secilin procesverbal veç e veç ashtu siç ishte propozim i z.Ekrem Rrahmani.

Njëzëri me 25 vota Për, nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, miratohet procesverbali nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më 11 dhjetor 2024, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

Njëzëri me 25 vota Për, nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, miratohet procesverbali nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më 30 dhjetor 2024, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

Njëzëri me 25 vota Për, nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, miratohet procesverbali nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më 29 janar 2025, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 25 anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 15 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur (të tjerët-Grupi i LDK-së nuk morën pjesë në votim me arsyetimin se nuk kan qenë pjesëmarrës në atë mbledhje), miratohet procesverbali nga mbledhja solemne e Kuvendit të Komunës e mbajtur më 17 shkurt 2025, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

2. Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Objektivit Çerdhe Publike në fshatin Balloc - Komuna e Podujevës

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, kemi të bëjmë me propozim vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektivit Çerdhe Publike në fshatin Balloc Komuna e Podujevës, pra kjo Çerdhe do të ndërtohet në Lagjen e Dëshmorëve, pra në atë pjesë por që është me Zonë Kadastrale të fshatit Balloc, prandaj urdhëroni nëse ndokush prej Ekzekutivit dëshiron fjalën fillimisht.

z.Avni Fetahu, drejtor i DKA, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, bazuar në planifikimet e Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për ndërtimin e Çerdheve publike në Komunën e Podujevës, Drejtoria e Arsimit ka identifikuar këtë parcelë të cilën e keni të bashkëngjitur me propozim vendimin e Kryetarit të Komunës, dhe kërkoj nga ana juaj që ta përkrahni.

znj.Arnisa Sylejmani, theksoi, dua të ndërlidhem pak me seancën e muajit të kaluar të datës 29 janar 2025 ku u diskutua dhe u votua propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Çerdhes në oborrin e shkollës “Enver Maloku” dhe me këtë rast dëshiroj të sqaroj disa pretendime të pavërteta që kanë tentuar të hapen në opinion nga drejtori i DKA-së. Është thënë se Lidhja Demokratike e Kosovës ka liruar sallën për të mos e përkrahur këtë pikë, kjo vetëm që nuk qëndron, kemi qenë të pranishëm gjatë diskutimit por unë në emër të Grupit e kam përkrahur dhe kemi votuar unanimisht pro këtij projekti.

LDK gjithmonë ka përkrahur çdo iniciativë e cila është në të mirë të qytetarëve dhe komunitetit, pa asnjë dallim, prandaj ftoj drejtorin e Drejtorisë së Arsimit dhe të gjithë ata të cilët kanë përhapur dezinformata të pasakta që të bazohen në të vërtetën. Madje për ta dëshmuar këtë e kemi edhe procesverbalin e mbledhjes përkatëse të Kuvendit të Komunës të datës 29 janar 2025.

Gjithashtu drejtori i DKA-së e dinë shumë mirë se edhe në mbledhjen paraprake të Komitetit për Politikë dhe Financa e kam përkrahur këtë pikë të rendit të ditës dhe ka pasë njohuri se do të jemi pro këtij projekti, andaj transparenca dhe korrektësia duhet të jenë parimet kryesore në vendimmarrje pa dallime.

Edhe sot si çdo herë tjetër unë ftoj Grupin e LDK-së ta përkrahim këtë propozim vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Çerdhes në fshatin Balloc. Pro këtij projekti dhe çdo projekti tjetër që është në të mirë të qytetarëve dhe banorëve të atij lokaliteti, edhe pse po tentoni të transmetoni në forma të pavërteta të gjitha këto propozim vendime për të cilat ne po votojmë pro dhe jemi gjithmonë pro tyre.

z.Haki Rudari, theksoi, ne kemi një propozim vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit Çerdhe Publike në fshatin Balloc, në një sipërfaqe prej 20 ha. Ky investim është nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe konsideroj se është një investim i një interesi të përgjithshëm duke marrë për bazë që sot po kemi çdo ditë e më shumë punësime të dy prindërve dhe përkujdesi ndaj fëmijëve sigurisht se po është brengë e të gjithë neve përgjithësi, andaj ky investim po bëhet për interes të qytetarëve dhe jam shumë i lumtur se po përkrahet nga të gjitha Grupet politike për arsye se fundja në Çerdhe fëmijët shkojnë pa dallime politike, prandaj në emër të grupit të LVV-së i japim një përkrahje të fuqishme dhe konsiderojmë se investime të tilla vetëm sa e risin mirëqenien e qytetarëve.

z.Bashkim Sylja, theksoi, edhe ne Grupi i PDK-ës jemi pro që të caktohet lokacioni për ndërtimin e Çerdhes në fshatin Balloc. Ne si Kuvend duhet që ta kryejmë obligimin tonë, kurse sa i përket realizmit të këtij projekti të gjithë e dimë që ky projekt financohet nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, ndoshta do të ishte mirë të sqarohej këtu lidhur me të caktim të lokacionit se a ka pasë dëgjim publik dhe a ka pasë ndonjë fizibilitet. Pastaj tjetra, shembull, Çerdhja që është duke e bërë Ministria e Arsimit tek pishat e qytetit që ka qenë projekt dy vjeçar, do të thotë qoftë në tabelë atje por edhe në kontratë shkruan që me 28 dhjetor 2022 ka filluar kurse me 28 dhjetor 2024 është dashtë të përfundoj ajo Çerdhe të jetë duke punuar, ndërsa ajo dihet që nuk është askund dhe nuk na është ndonjëherë neve këto ndonjë raport përse është vonuar, kush e vonoj dhe pse, a është gati e të tjera informata.

Pyes se a do ta pret edhe këtë fati i njëjtë ngase datat se kur kryhen po figurojnë pro ato nuk po kryhen me kohë, madje pa kurrfarë arsyesh nuk po kryhen sepse në rast se ka pengesa, por pa kurrfarë arsye. E them këtë sepse ajo Çerdhe që ka pasë të kryhet në vitin 2024 realisht me kapacitet normal po të punohet ashtu siç është duke u punuar as në këtë vit që jemi nuk kryhet.

z.Avni Fetahu, drejtor i DKA, theksoi, fillimisht ju falënderojmë të gjithëve për vullnetin dhe gatishmërinë për t'i përkrahë këto projekte të tilla, pa dyshim se do të ishte shumë gabim politik prej anës tuaj që mos t'i përkrahni.

Çështja tjetër, për tu rikthyer në seancën e kaluar unë nuk kam shpërndarë asnjë lloj dezinformate veç se kam pasqyruar një realitet që ka ndodh atë ditë. Do të duhej pa marrë parasysh pozicionin politik qoftë pozitë apo opozitë, atë ditë keni mund të thoni se është pika e parë e rendit të ditës, po e votojmë edhe këtë pikë dhe po dalim, por ju atë ditë keni dalë prej seance dhe unë e kam pasqyruar atë fakt, tjetër gjë nuk kam pasqyruar aty veç atë që ka ndodh.

Te çështja e Çerdhes se a duhet të bëhet dëgjim publik, procedurat janë të qarta, aty bëhet fjalë për brenda oborrit të shkollës në Lagjen e Dëshmorëve të Kombit dhe nuk është se ka nevojë për ndonjë fizibilitet për vendosjen e një Çerdhe kur aty veç është e vendosur një shkollë në atë oborr dhe ka hapësirë të mjaftueshme.

Sa i përket Çerdhes që është tek pishat e qytetit, do të thotë është në fazën e fundit finale dhe Ministria e Arsimit çdo projekt të investimit kapital e kishte të ndarë në tri faza dhe mund të ketë ankesa në Organin e Shqyrtimit të Prokurimit Publik përmes kompanive që janë krijuar këto vonesa, mirëpo të thuhet që nuk është kërkund objekti, ai objekt është aty, është duke u fasaduar dhe është duke u punuar dhe është në përfundim e sipër.

z.Naim Çunaku, theksoi, fare nuk isha i interesuar të marrë pjesë në të debat por vërtetë të përsëritet e njëjta dhe të mos pranohen lëshimet sepse njerëz jemi dhe mund të kemi lëshime dhe mund të kemi gabime, por është njerëzore edhe të pranohen ato e që nuk po dua ta them që nëse nuk i pranon çka është.

Zotëri drejtor i DKA-së, unë atë ditë në foltore e kam thënë se nuk ikim, ngase ta sqarojmë edhe publikun edhe sallën, deri sa unë kam diskutuar, ti nga vendi ku je ulur ke thënë, keni ikë, dhe në foltore unë e kam thënë se ne nuk ikim sepse nuk kemi asnjë arsye të ikim, nuk kemi asnjë diçka të ngushtohemi ose të ikim prej qytetarit, përkundrazi këtu jemi për mbrojtjen e interesave të qytetarëve. Vërtetë unë me vonesë e kam parë atë postim, jam ndjerë keq, pra jam ndjerë keq kur një drejtor i Ekzekutivit jep një lajm jo në përputhje me ngjarjen e vërtetë, por po mundohem të jem shumë i kursyer në fjalorë. Pra të konstatoj që Grupi i LDK-së nuk e ka votuar lokacionin për ndërtimin e Çerdhes, më së buti të them ka qenë një manipulim i opinionit, pse po e them këtë, zonja parafolëse Arnisa përmendi procesverbalet të cilat janë publike dhe çdo kush mund t'i shihet, në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa-KPF si pararendëse e vendimeve të Kuvendit, Grupi i LDK-së dhe të gjithë anëtarët e KPF-së në mënyrë unanime e kanë votuar atë lokacion dhe nëse nuk është kështu lus anëtarët e KPF-së që janë këtu dhe që kanë qenë prezent në atë mbledhje, nëse nuk është kështu le ta thonë të kundërtën unë jam i gatshëm të ballafaqohemi.

Kur kemi ardhur në seancën e Kuvendit, shkak i asaj qysh po na ndodhin seancat e që është goxha e pandershme që gjatë diskutimit tim dikush nga vendi gjuan llafe. Edhe në atë seancë të Kuvendit LDK gjegjësisht Grupi i LDK-së është pjesëmarrës në votimin për caktimin e lokacionit, dhe atë në mënyrë unanime, tani cila është e vërteta këtu, a është procesverbali si dokument zyrtar i dy mbledhjeve KPF dhe Kuvendit, apo ajo që shkruhet nëpër Facebook.

Unë kurrë dhe asnjëherë me askënd nuk dua të rëndoj raporte ndërnjerëzore, në veçanti nuk dua që të merre dikush poenë politik e që nuk i vyejnë askujt ato poena politik me manipulime, në këtë rast po e them manipulim që është manipuluar opinionin publik me atë status, dhe po e mbyllë me këtë fjalë, drejtor me gjithë respektin por cili subjekt dhe cili grupim politik i faturon vetit me veprimet e tij humbje apo fitore, ne i kemi organet e ndara në kuptimin politik dhe politikën që i zhvillon LDK ka një instancë të cilat i zhvillon, mund të shprehësh keqardhje që LDK nuk po din të punoj mirë dhe ta mund LVV-në e që mund të shprehësh keqardhje, por ne mendojmë se jemi duke punuar mirë sepse në rend të parë e kemi interesin qytetarë.

znj.Arnisa Sylejmani, theksoi, meqenëse drejtori i DKA-së nuk e pranoi që ka bërë në gabim, unë po ndërlidhem sërish tek ajo çka ka shpërfaq ai në statusin e tij në Facebook nuk ka qenë e vërtetë, nëse mund ta citoj ka thënë “mandej me ik kur vjen pika për propozim vendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Çerdhes”, i nderuar drejtor e din ti mirë dhe çdo qytetarë që e ka përcjellë seancën e kaluar të Kuvendit se përse e kemi liruar sallën ne, pika e rendit të ditës për të ciklën ti ke fol në statusin tënd është përkrahur prej neve, andaj më e pakta që sot po kërkoj prej teje, meqenëse kam folur në emër të grupit, të kërkoj falje. Sot meqë nuk e paskemi liruar sallën dhe e përkrahëm këtë pikë të rendit të ditës po kërkoj prej teje të qitësh një status dhe t’ju tregosh opinionit që e kemi përkrahur.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, drejtori i DKA-së jo që prej muajit të kaluar i ka luajtur fjalët por këtu mua mi lëkund fjalët e mia. Unë i thash që ajo Çerdhe nuk ish kërkuar hiq në rend për tu kryer, sepse nuk e thash unë që nuk është objekti. Unë thajse 10 apo 20 herë kam shkuar në atë objekt, madje e di edhe sa dhoma ka, kam shkuar edhe me gazetar e kam vizituar, prandaj unë i tregova që objekti, madje hyra e shikova këtu sepse paksa me datë i’a huqa në fjalimin e paraprak ngase nuk paska qenë me 28 dhjetor por me 15 dhjetor 2022 që ka filluar, dhe për t’i treguar këtij që të mos manipuloj me fjalë dhe të shpifë, pasi të lidhet kontrata nuk ka më ankesa, por kontrata

lidhet dhe i ka datat kur të filloj dhe kur të përfundoj puna, nuk ka më as OSHP as asgjë. Në atë minutë që nënshkruhet kontrata nuk ka më afate të tilla dhe ato afate të ankesave t'ia tregoj ky dikujt tjetër. Pra ky projekt ka pas për të kryer më 15 dhjetor 2024 dhe ka kushtuar 687,407.93€. pra kam qenë disa herë e kam vizituar, madje kam edhe foto që kam qenë, prandaj nuk e thash unë që nuk ekziston objekti, por thash që ka pas për tu kryen në fund të vitit 2024 e që unë dyshoj se a do të kryhet edhe në vitin 2025.

z.Avni Fetahu, drejtor i DKA, theksoi, e nderuara asamblistë zonja Arnisa, unë edhe herën e kalua por edhe tani po e përsëris, ju kur ka ardh pika në fjalë keni dalë prej seancës, tani jeni rikthyer dhe normal që e keni votuar sepse do të bënit gabim politik nëse nuk do ta votonit.

Edhe në këtë seancë që e votoni shumë mirë bëni që e votoni dhe do ta qes një status me të cilin edhe do t'ju falënderoj, veçse e keni edhe ju obligim për të ma bërë like pastaj, mos harroni.

z.Artrit Mulliqi, theksoi, mua më vije mirë që ka evoluar debati sepse nga Çerdhe publike të cilën e kemi gjetur e cila ka funksionuar për 20 vite, tash po flasim për data të caktuara se kur do të fillojnë dhe kur do të kryhen Çerdhet tjera. Për 5 veç e di që janë funksionale dhe gati në çdo seancë po kemi Çerdhe të reja kështu që unë vetëm mund t'i falënderoj, dhe një like e ke z.Avni Fetahu për punën që ke bërë deri tani.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, as unë nuk e pata ndërmend të foli por më bëri të marrë fjalën kolegu parafolës z.Artit Mulliqi i cili e tha që po më pëlqen që ka evoluar tash dhe që tani po bëjmë Çerdhe më shumë. Unë them që edhe mua po më pëlqen tani që pas 20 viteve qeverisje ku ky (z.Avndi Fetahu) vet ka qenë drejtor por edhe Kryetari aktual i Komunës ka qenë drejtor, më në fund kanë marrë mësim që duhet të bëhen Çerdhe dhe duhet të bëjnë për arsimin, bile këto Çerdhe, kështu që kjo është që kanë mësuar dhe kanë marrë mësim që përbrenda 20 viteve t'i bëjnë këto gjëra, por njëmend nuk i mban mend ti ato.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, i falënderoj parafolësit për diskutimet, lutemi të kemi fëmijë sa më shumë dhe që Çerdhet të mbushen, kjo është urimi im.

Debati si duket përfundoj dhe nuk po e zgjatim më shumë këtë temë ngase si debat ishte konstruktiv, andaj e hedh në votim këtë propozim vendim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 30 vota Për, nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, miratohet propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Objektivit Çerdhe Publike në fshatin Balloc-Komuna e Podujevës, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

3. Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare Ndërmarrjes Publike Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” Sh.A

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, kemi një propozim që t'i ndahet një shumë e caktuar e mjeteve financiare KRM “Pastrimi” e cila ka telashe financiare, andaj për këtë më mirë mund të na informoj drejtori i DBF-së.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth këtij propozim vendimi, theksoi, Kompania “Pastrimi” ka bërë një kërkesë drejtuar Komunës së Podujevës si aksionare në këtë Kompani, për ndihmë financiare të kësaj Ndërmarrje duke pasë parasysh gjendjen jo të mirë të cilën e ka kaluar kjo Kompani, gjendjes jo të mirë edhe të makinerive si dhe obligimeve që ka kjo Kompani, posaçërisht në Kompaninë për deponimin e mbeturinave ku rrezikohet komplet rajoni i

Prishtinës në qoftë se bllokohet deponimi i mbeturinave me mbet pastaj pa grumbullim të mbeturinave te ekonomit familjare dhe te bizneset.

Arsyeshmëria për ndihmë financiare kësaj Ndërmarrje duke pasë parasysh këtë, ekziston.

Kërkesa e tyre është për 99,500.00€ mirëpo duke pasë parasysh kufizimet buxhetore e kemi parë të arsyeshme që t'i ndahet një shumë financiare prej 60,000.00€ dhe që kj të paguhet në dy pjesë, pra 30,000.00€ në vitin 2025 dhe 30,000.00€ në vitin 2026, e që edhe kjo ndarje normal vie duke pasë parasysh kufizimet buxhetore të cilën e kemi në kategorinë e subvencioneve në buxhetin komunal. Ju ftoj që ta mbështetni këtë subvencion, me shpresën dhe besimin që kjo Ndërmarrje do të konsolidohet dhe pastaj që të mos kemi më nevojë për ndarjen e subvencioneve të veçanta nga ana e buxhetit komunal, edhe pse jemi aksionarë në këtë Ndërmarrje.

z.Florent Hasani, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e mbështesim këtë ndihmë për Kompaninë “Pastrimi”, e ndarë në dy pjesë, 30,000.00€ në këtë vit dhe 30,000.00€ në vitin tjetër.

z.Naim Çunaku, theksoi, lidhur me kërkesën e Kopanisë “Pastrimi” drejtuar në rend të parë Kryetarit të Komunës së Podujevës, dhe në rend të dytë Kryetari atë e adreson te Kuvendi i Komunës ashtu siç do rendi dhe vendimmarrja për një pjesë të këtyre mjeteve e që është jo e vogël, por që ata kanë kërkuar 99,500.00€ ndërsa propozimin në Kuvend e kemi për 60,000.00€ dhe atë të ndarë në dy vite kalendarike e që në një formë ne që momentalisht e kemi mandatin tani, ata që do ta ushtrojnë mandatin në zgjedhjet tjera ne po jua përcaktojmë gjegjësisht po i'u krijojmë humbje ose po i'u krijojmë shpenzimin e buxhetit edhe legjislaturës tjetër gjegjësisht Ekzekutivit tjetër nëse nuk përsëritet e njëjta, por zgjedhjet janë zgjedhje.

Edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa por edhe sot këtu ju thërras që t'i thërrasim arsyet dhe nuk është një vendim do si do kur kemi parasysh që një Ndërmarrje Publike vetë financuese që kryen shërbime dhe inkason të hyra për shërbimet që i bënë, nëse ne intervenojmë siç kemi filluar me “Eko-Llapin” “Stacionin e Autobusëve” tani “Pastrimin” pastaj Ujësjetllësin e që ndoshta dikush thotë që në Ujësjetllës nuk kemi kemi dhënë subvencion, e vërtetë që nuk kemi dhënë subvencion mjete të gatshme por kemi dhënë asete që janë ndërtuar me mjetet e këtij Kuvendi, qoftë tubacione të furnizimit me ujë qoftë tubacione që trajtojnë ujërat e zeza, dhe që të dyja në atë moment që janë kryer kanë kaluar si asete menaxhuese të KRU “Pastrimi”.

U dëgjua dhe u fol që në Kompaninë “Pastrimi” Komuna e Podujevës është aksionare, dhe jo vetëm Komuna e Podujevës por edhe disa Komuna tjera, e vërtetë se ashtu është, ne në këtë Kuvend kemi nominuar gjegjësisht kemi vendosë që në emër të aksioneve që i kemi në Kompaninë “Pastrimi” kemi caktuar aksionarë nga ky Kuvend, dhe cili është raporti ose cila është puna e atyre aksionarëve që ne i kemi caktuar atje, dhe se qe tri mbledhje vazhde kemi tentuar t'iu krijojmë benefite financiare atyre që i caktuar aksionarë atje, ndërsa në të njëjtën kohë themi se ata janë në gjendje të vështirë ekonomiko-financiare. Shtrohet pyetja, të nderuar kolege dhe kolegë asambliste/ë a jemi ne “zjarrfikësit” që duhet të intervenojmë, ose në muajin e Ramazanit të bëjmë Rahmet, te Ndërmarrjet që operojnë dhe që për koston e tyre dhe për shërbimin e tyre marrin mjete, a mendojmë ne si përfaqësues të qytetarëve që jemi duke e ngarkuar qytetarin e Komunës së Podujevës sepse Kompania “Pastrimi” nëse vetëm 50 euro i ka ndokush borxh ajo e dërgon te përmbauesi dhe i'a shton atij borxhin edhe për 100 euro, dhe ata njëherë paguajnë Kompanisë “Pastrimi” ndërsa herën e dytë vijnë përmes vendimeve të Kuvendit, sepse dihet qysh është buxheti i Komunës që është grandit qeveritar dhe të hyrat vetanake, dhe ne nga këto pozicione ndajmë mjete financiare për Kompani të caktuara, prandaj a mendoni të nderuar kuvendar që ne në këtë rast ne po ndërhyjmë drejtpërsëdrejti në konkurrencën e lirë të operatorëve ekonomik, a mendoni të nderuar kuvendarë që me këtë po favorizojmë dhe po ndëshkojmë kompani të cilat operojnë në Komunën tonë.

Ajo çka është më e rëndësishme për qytetarët dhe për ne si vendimmarrës, më shumë se para neve, para ligjit janë të barabartë si kompania publike, si kompania private. Jemi në ekonomi të tregut të lirë, dhe përse nuk kemi kërkesa tjera, kur jemi në dijeni se në trevën e Komunës së Podujevës operon edhe një operator privat, a jemi duke i hyrë në hak pse atij asnjëherë nuk i ndihmuam asnjëherë me mjete financiare. Nëse po u dashka që me para të buxhetit, dhe t’jua shkurtojmë mundësitë investive të Komunës duke i’u ndarë organizatave e që për mendimin tim nuk do të duhej t’ju ndaheshin, kjo nuk do të doja që kaq lehtë të kaloj, ose që të merret një vendim që të subvencionohet në një masë, në një formë kaq.

Ne nuk jemi ata që kontrollojmë menaxhmentin e atyre Ndërmarrjeve, por nuk na e cungon askush të drejtën neve të jemi në njohuri për ecuritë e Ndërmarrjeve Publike dhe vetëm një do të doja prej atyre që janë aksionarë në Ndërmarrjen “Pastrimi”, a mundet ndokush prej tyre të na tregoj, sepse para tyre ka dashtë dikush të raportoj, sa donacione ka ajo Ndërmarrje, sa subvencione ka ajo Ndërmarrje, cilat janë shërbimet që i kryen, dhe nëse dikush mendon se në ekonominë e tregut duhet të ndërtohet një Ndërmarrje dhe pasta duke lyp mjete falas prej dikujt, ekzistojnë mënyra..., sepse ne kur po kemi ndonjë telashe financiare po shkojmë nëpër Banka dhe po marrim kredi.

Pa dashur të hyjë në menaxhmentin edhe njëherë, ata e kanë mbipopulluar atë Ndërmarrje, marrin donacione kamionë dhe komutat tjera, kurse në fund thonë jemi në gjendje të keqe financiare, mendoj dhe të paktën Grupin e LDK-së e thërras që të paktën të mos jetë pjesë e ndarjes së këtyre mjeteve, të abstenoj, me arsyetimin që jemi duke i shkurtuar të mirat që do të mund të realizoheshin në Komunën tonë.

E patëm pak më herët Foshnjoren dhe Arsimin, me sa tabela digjitale do të mund të furnizoheshin shkollat tona me ato mjete, pastaj kemi nevojat tjera të qytetarëve, çka bëhet me shoqëritë e margjinalizuara në Komunën tonë që e kanë nevojë jetike subvencionin dhe ndihmën që duhet ta marrin nga institucionet dhe që e ka obligim ligjor institucioni të kujdeset për ata.

Vërtetë nuk mendoj në një formë që jemi duke e shpenzuar buxhetin me nikoqirllëk dhe për hatër dhe për asgjë të askujt nuk do të doja që LDK gjegjësisht Grupi i saj të jetë pjesë e kësaj vendimmarrje, andaj edhe njëherë për fund ju ftoj që ne të abstenojmë nga ky proces dhe nuk marrim pjesë në votim.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, kjo pikë për subvencionim të Kompanisë “Pastrimi” mu duk goxha shumë interesante. Me pikat që u tërhoqën më herët, shembull që janë prej Komunës tre aksionarë prej tyre dy anëtarë të Kuvendit dhe një prej Ekzekutivit e që u tentua të hyjnë në rend të ditës për kompensimin e tyre dhe atë retroaktiv do të thotë për një Ndërmarrje tre persona, diku për 40 muaj nga 350 euro bëjnë rreth 42,000.00€, qysh po këqyrni t’ju jepni aksionarëve 42,000.00€ kurse Kompanisë “Pastrimi” subvencion 30,000.00€. a është ky subvencionim për t’i paguar ata aksionarë apo për t’i ndihmuar asaj Kompanie.

Çështja tjetër, Kompanisë “Pastrimi” i janë heqë të gjitha kontratat, drejtori i DSHPMSh është këtu prezent, shembull ka pasë kontratë ajo Kompani me Komunën e Podujevës për t’i larë disa rrugë, sheshin e që nuk është që e lante aq mirë por një natë po një natë jo e lanin, kurse kjo tjetra Kompani tash që e ka marrë kontratën vetëm i merre paratë dhe nuk e lanë kurrë, pastaj e ka pasë për mirëmbajtjen e disa oborreve të shkollave dhe disa kontrata tjera, dhe ka qenë një lloj ndihme, ndërsa tani asaj i janë hequr ato punë dhe ka mbete vetëm me grumbullimin mbeturinave dhe për këtë në qytet nuk është se është shumë keq gjendja por nëse dalim jashtë qytetit shembull në rrugën Balloc-Herticë në të dy anët e rrugës ka mbeturina dhe në gjitha anët ashtu. Unë nuk po e them se ajo Kompani duhet ta mbledh bërlllogun çka nuk janë nëpër kontejner e të tjera, por nuk është që është duke bërë ajo Kompani ndonjë nam që ne ta subvencionojmë për çdo vit nga 30,000.00€ e 60,000.00€, kështu që edhe unë jam kandër këtij propozim vendimi.

z.Bashkim Syla, theksoi, vetëm një sqarim sa i përket diskutimit të parafolësit **z.Ekrem Rrahmani**, pikat që ishin më herët për të hyrë në rend të ditës nuk ishin për komisionin e aksionarëve të ndërmarrjes KRM “Pastrimi” por ishin për krejt komisione tjera të tjera Ndërmarrjeve, kështu që kjo nuk pati lidhje me këto mjete që janë propozuar t’i ndahen Kompanisë “Pastrimi”.

Po ashtu sa i përket pagës minimale 350 euro, çdo Kompani e ka të rregulluar pagën minimale dhe kjo është me ligj ku çdo aksionarë e merr pagën minimale e q ka qenë rreth 220 euro sa kujtoj, mirëpo kjo nuk pati lidhje me këtë temë që tani jemi duke e diskutuar e që është për Ndërmarrjen “Pastrimi”, por ato ishin krejt dy çështje tjera.

z.Ekrem Rrahmani, përgjigje parafolësit, theksoi, unë nuk e thash që kanë lidhje këto dy çështje, por nëse ti i nderuar kolegë nëse kthehesh prapa dhe e shikon dhe nëse do të votoje për ato dy pika për rend të ditës, ajo Kompani jo 220 euro por paga minimale është rreth 350 euro dhe Kompania do të detyrohej që aksionarëve t’jua jep ato para, por tani këtu i jepen subvencion 30,000.00€ kurse ajo ka për t’i dhënë 42,000.00€ nëse do të votohet për kompensim të aksionarëve, unë e thash që ku e ka fitimin pastaj ajo Kompani, këtu ishte logjika.

z.Bashkim Syla, sërish ndërhyr duke i’u përgjigjur parafolësit që kjo çështje që po diskutohet ka të bëjë me Kompaninë “Pastrimi”, ndërsa ato dy pikat që u trajtuan për të hyrë në rend të ditës në fillim të kësaj mbledhje janë për Ndërmarrjet tjera, s’kan të bëjnë asgjë me këtë pikë të rendit të ditës që po e trajtojmë tani.

z.Adnan Zymeri, theksoi, unë pajtohem paraprakisht me atë që e potencoj kolegu **z.Naim Çunaku** më herët lidhur me punën që e ka bërë menaxhmenti i kësaj Kompanie ndër vite dhe nuk është hera e parë që po i japim mbështetje, por përveç kësaj në kërkesën që e ka adresuar ajo Kompani për Kuvendin e Komunës, në bazë të këtyre shifrave që i ka shkruar nuk bëhet fjalë për 99,500.00€ por shkruan 99 milion e 500 mijë euro, kjo do të thotë tregon për seriozitetin e kërkesës që e ka, kështu që nuk e besoj që mund t’i kryejnë punë diçka 60,000.00€.

z.Fatmir Gashi, theksoi, unë mendoj që Kompanitë të cilat me vite të tëra operojnë me humbje të vazhdueshme dhe shndërrohen në barrë të Komunës, është mirë që të bisedohet, të shikohet dhe të analizohet seriozisht puna dhe të fusim në treg kompani të cilat punojnë pa humbje dhe i kryejnë punët si duhet.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSh, theksoi, për disa çështje të cilat u ngritën po mundohem t’i jap disa sqarime dhe t’i arsyetoj edhe pse ky arsyetim nuk do të jetë i domosdoshëm që të votohet ky propozim vendim, por si do që të jetë, të jetë në ndërgjegjen e gjithsecilit.

Ndërmarrja KRM “Pastrimi” është në gjendje shumë të keqe financiare dhe është në borxhe te Kompania për Deponimin e Mbeturinave ashtu siç e përmendi edhe drejtori i DBF-së më herët dhe tani rreziku është që të mbetet pa u mbledh mbeturinat nëpër ekonomitë familjare.

U fol shumë për mbeturina që ka gjithandej sikurse që u përmend rruga Balloc-Herticë dhe në shumë vende tjera, mirëpo kjo pikërisht është pasoja pse ka mbeturina gjithandej për shkak se ne hezitojmë të paguajmë 4.75 euro në muaj Kompaninë “Pastrimi” e që kjo e bënë edhe deponimin e mbeturinave dhe njëkohësisht e ulë edhe koston financiare të KRM “Pastrimi”, do të thotë i ka dy efekte negative, 1-krijon këto deponitë e egra ilegale të mbeturinave, dhe 2-ulë koston e atyre që tashmë nuk i’u dalin mjetet financiare as për t’i paguar mbeturinat që ata i dërgojnë tek deponia përkatëse, ngase secilën mbeturinë që e mbledhin prej juve ata duhet të paguajnë në deponinë e mbeturinave për ta zbratur aty, prandaj është kjo kërkesë e tyre.

Në Komunën e Podujevës pothuajse shumica e territorit mbulohet me mbledhjen e mbeturinave edhe pse nuk inkasohet e gjitha e që edhe ky është një problem në vete sepse ata shkojnë dhe i mbledhin mbeturinat tek ekonomitë familjare të cilat nuk e paguajnë bërlllogun ta them kështu shkurt dhe shqip.

Sa i përket asaj që u tha që pse nuk po ndihmohen apo subvencionohen edhe ndërmarrjet tjera, nuk e kemi obligim ne të subvencionojmë ndërmarrje private por ne jemi të obliguar për ndërmarrjet tona që janë dhe aty ku ne jemi aksionarë e që në këtë rast KRM “Pastrimi” është regjionale mirëpo ne jemi aksionarë në të me 7.8 % të aksioneve, dhe sikur të mos ishim aksionarë ata nuk do të kryenin as shërbime në Komunën tonë.

U përmend kontrata me KRM “Pastrimi” që u tha se tani është shkurtuar ajo kontratë dhe i janë heqë disa aktivitete, është e vërtetë që janë heqë disa aktivitete mirëpo ajo Kompani prap kryen punë në bazë të fushëveprimit që e ka, mirëpo që ne është dashtë që tani ta fuqizojmë paksa me disa aktivitete edhe Ndërmarrjen tonë të re që e kemi “Eko-Llapi” dhe secili aktivitet që është heqë nga KRM “Pastrimi” ka kaluar te NPL “Eko-Llapi” në mënyrë që të mos ketë dyfishim apo konflikt të aktiviteteve në dy Ndërmarrje.

Vërtetë unë po mendoj që një kosto apo një subvencion në shumë 60,000.00€ tek një Kompani që nuk mundemi pa atë e që këtë duhet ta kemi të qartë se nuk mundemi pa atë Kompani tani për tani, nuk është ndonjë kosto e madhe, dhe nuk është që do t’i bëjmë zgjidhje sepse nuk do të mund t’i bëjmë zgjidhje afatgjate, por do t’jua japim një shtytje sa për të mos qenë të penalizuar në Deponinë përkatëse me rastin e dërgimit të mbeturinave që i mbledhjen në qytet dhe më gjerë, asgjë më shumë, mirëpo po nisemi gjithsecili nga vetja sepse fajtor jemi edhe ne, he këtë e thash edhe njëherë, mbledhja e mbeturinave bëhet pothuajse në gjithë territorin e Komunës së Podujevës, ndërsa inkasomi apo pagesa e mbeturinave nuk bëhet nga secila familje.

Për një raport të gjendjes çfarë është në Kompaninë “Pastrimi” unë si aksionarë në të mund ta kërkoj një raport nga Kryeshefi Ekzekutiv dhe nga Bordi që është në Ndërmarrje e të cilin pa asnjë problem mund ta paraqes edhe para juve si Kuvend i Komunës sepse është e drejtë e juaja ta kërkon por është edhe e drejtë e jona ta sjellim atë raport në Kuvend në mënyrë që ta dimë edhe gjendjen financiare të asaj Kompanie dhe gjendjen faktike për secilin aktivitet që ajo e kryen brenda territorit të Komunës së Podujevës.

znj. Arnisa Sylejmani, theksoi, një pyetje e kam për drejtorin e DSHPMSH, gjatë këtij mandati prej vitit 2021 sa e di unë edhe njëherë tjetër i kemi ndarë mjete financiare kësaj Ndërmarrje dhe sa më kujtohet e që mund të jem edhe gabim, që atëherë kur ka kaluar ajo pikë e rendit të ditës për t’u shpërndarë ato mjete tek Kompania “Pastrimi” keni thënë që do të jetë hera e fundit që ne do t’i ndihmojmë kësaj Ndërmarrje sepse nëse nuk mundet ajo të menaxhoj vetë si Ndërmarrje atëherë duhet të shuhet, kështu ka qenë pak a shumë përgjigja juaj.

Ti drejtor e the se të mbetet në ndërgjegjen e gjithkujt, por ka qytetarë që e paguajnë koston prej 4.75 euro, dhe në momentin që i’a japim këtë pjesë të subvencionimit i bie që ata qytetarë të cilët e paguajnë atë kosto, po e paguajnë dy herë sepse me taksa edhe të tyre po bëhet kjo.

z. Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, duke i’u përgjigjur shkurtimisht parafolëses në këtë çështjen e fundit, theksoi, nuk i bie ashtu siç u tha sepse i bie për ata që nuk po e paguajnë.

z. Naim Çunaku, theksoi, në fjalinë e fundit që e pati drejtori i DSHPMSH kur e tha që ne e kemi të drejtën për të bërë raportimin, i nderuar drejtor...

z. Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, ndërhyri duke i thënë që unë e thash që ju duhet të kërkonit dhe ne raportojmë.

z. Naim Çunaku, vazhdoi, i nderuar drejtor ju lus derisa të diskutojmë dhe pastaj ta merrni fjalën, raportimi para Kuvendit është obligim ligjor, nuk është vullnet e as e drejtë por është obligim ligjor që çdo Ndërmarrje ku ka influencë financiare Komuna e Podujevës në këtë rast, siç paraqiten raportet periodike financiare qoftë vjetore qoftë tremujore, kish dashtë që Kuvendi Komunal si nominues dhe si zgjedhës i atyre përfaqësuesve në ato Ndërmarrje Publike të ketë kthesë/feedback se cila është gjendja e atyre Ndërmarrjeve.

Pra është obligim ligjor dhe nuk ka ndodh kurrë. Pastaj po dal tek fjalia e fillimit në diskutimin e juaj e që vërtetë më bëri të ndihem keq i nderuar drejtor kur e the, le të mbetet në ndërgjegjen e gjithsecilit votimi, do të thotë unë u ndjeva keq dhe tani po tregoj përse, kur të flasësh për ndërgjegjen e tjetrit sigurisht që këndvështrimi i një diçkaje mund të jetë prej cilës perspektivë e shikon, për mua si anëtar i Kuvendit të Komunës i zgjedhur prej qytetarëve obligim ligjor dhe parësor e kam që ta përfaqësoj atë drejtë dhe t'i mbrojë interesat e tij, dhe hiq nuk ndihem me ndërgjegje të rënduar pse nuk jam duke kontribuar në maniverzimet e Ndërmarrjeve gjithandej Kosovës e edhe në këtë që po diskutojmë sot, e që ke raporte nga më të ndryshmet, qoftë me mbipopullim qoftë me prishje të kamionëve e të tjera sepse këtu jetojmë, çka bëjnë me ato, por do të ndihesha shumë me ndërgjegje të rënduar kur shikoj që brenda një viti financiar Komuna e Podujevës siç e përmenda edhe pak më parë se çka bënë me kategoritë e marginalizuara, Handikos-it Komuna jonë i ndanë 9,500.00€ dhe ata duhet t'i kryejnë shërbimet e transportit nëpër shkolla, e të mos hyjmë te statistikën që 1% e banorëve të Komunës së Podujevës lëngon qoftë prej sindromit DOWN, qoftë tetraplegjik, me autizëm e të tjerë të cilët kanë nevojë edhe njerëzore edhe morale edhe institucionale, dhe thash që të orientohen ato mjete total, sepse fundja në rend të parë unë e mbrojë interesin e qytetarit.

Edhe një fjali i nderuar drejtor i DSHPMSh, kur thuhet që ne jemi aksionarë dhe ne i subvencionojmë Ndërmarrjet tona, nëse për mua dhe besoj kish dashtë për të gjithë ata që merren apo që në këtë rast përfaqësojnë institucionin, qoftë qytetarin, qysh dhe pse duhet, nuk po e përmendi emrin e Kompanisë, por nëse të njëjtin shërbim na e kryen një Kompani private me 4.90 euro ose 4.50 euro që është private, pse unë duhet t'i paguaj kësaj që është publike dy herë, e që ti drejtor e the që nuk e paguajmë dy herë, unë e them që po dy herë e paguajmë, njëherë drejtpërdrejt në Kompani, kurse herën tjetër nga buxheti qoftë ai nga granti qoftë nga të hyrat vetanake të Komunës e që në vend që ato mjete t'i orientojmë diku tjetër ne prap i'a orientojmë asaj Kompanie, kjo pra i bie dyfish e paguar dhe nuk ka logjikë tjetër këtu.

Mirëpo i nderuar drejtor, ne mund ta kemi këtë kundërshti unë dhe ti, që unë e di që Kosova dhe rendi qeverisës në Kosovë është ku konkurrenca e lirë është e barabartë në mes operatorëve ekonomik, dhe favorizimi i njëres e mbytë konkurrencën, krijon monopol e që e kemi të ndaluar edhe ligjërisht krijimin e monopolit. Krejt njerëzisht për fund, nuk e di pse duhet që dikë ta mbajmë qoftë edhe i kësaj Komune kur ai nuk mund të qëndroj në këmbë të vetat. Drejtori e përmbylli fjalën paraprakisht duke thënë që nuk do t'i ndihmojmë asgjë me këto mjete asaj kompanie sepse janë pak, por atyre unë mendoj se edhe po që se krejt buxhetin po t'jua dhurojmë dinë ta shpenzojnë, por ne nuk jemi për t'iu dërguar atyre buxhet por për ta menaxhuar dhe harxhuar këtë buxhet të Komunës që e kemi për të mirën e qytetarëve tanë.

z.Fatmir Gashi, theksoi, sërish rreth kësaj çështje, mendoj se sa i përket ndërgjegjësimit po vërehet se ku jemi me ndërgjegjësim sidomos sa i përket hedhurinave, andaj do kërkoja nga Drejtoria përkatëse gjegjësisht inspektoriatin që të ndërmerr masa e mos ta lëm vetëm në ndërgjegjësim, të vë edhe gjoba, e jo pra vetëm ndërgjegjësim, ndërgjegjësim, sepse aty ku nuk ka ndërgjegjësim është mirë të përdoren edhe ndëshkimet në mënyrë që pastaj nuk do t'i përsëritin shumë. Të shikohet mundësia e krijimit të një fondi për gjithë një shkelje të madhe që bëhet me hedhurimin e mbeturinave dhe që çdo kund gjenden sepse ne jemi kënde i shohim dhe i vërejmë, andaj meqë nuk po ndërgjegjësohemi, po i meritojmë dënimet dhe më në fund të jetë edhe inspektoriatin më seriozë dhe të filloj me ndëshkime pas kaq viteve.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, edhe unë dua të ndërlihem me një fjali të drejtorit parafolës të DSHPMSh i cili gjatë fjalimit e tha, nisuni prej vetit sa i përket kësaj gjendje, andaj meqë na u drejtove ashtu, nisuni prej vetit, po ju sqaroj që personalisht ne e paguajmë këtë kosto prej 4.70

euro sa është për këtë shërbim nga Kompania në fjalë, por a nisesht ti drejtori prej vetit që ta dish që nuk na e ke sjellë kurrnjëher ndonjë raport në Kuvend se çka është duke bërë ajo Kompani, ku është tek është.

Po ashtu drejtori në fjalë e tha që nuk i bie që qytetarët paguajnë dy herë, do të thotë që Kuvendi po paguan për ata qytetarë që nuk paguajnë fare, andaj pyes se a jemi duke e dhënë një shembull të keq tek qytetarët, pse të qohet dikush që e ka paguar tash e sa vite dhe tani të vazhdoj ta paguaj kur e sheh që Kuvendi i Komunë vit më vit i ndan fonde kësaj Kompanie, e që pastaj mund të ketë edhe nga të tjerët që thonë nuk po paguaj sepse paguan Kuvendi i Komunës për neve, prandaj mendoj që me këtë jemi duke e dhënë një shembull të keq te qytetarët që mos ta paguajnë as ata këtë kosto të mbledhjes së mbeturinave.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSh, theksoi, në fillim nuk deshta të bëjë shumë polemika por vetëm t'i jap disa sqarime që veç u kërkuan nga ana juaj, por tani më detyruat të bëjë edhe polemika, dhe këtë e filloj me të nderuarin z.Fatmir Gashi ish Kryesues i Kuvendit e që nuk e di a ka qenë Kryesues i Kuvendit apo asambleist në kohën kur ju i keni mbete borxh 100,000.00€ kësaj Kompanie dhe ai borxh është bartur tek ne tani e që ne po i vuajmë pasojat e atyre 100,000.00€ që ju nuk i'a keni dhënë Kompanisë "Pastrimi", pra na trego se në cilin funksion ke qenë sepse nuk po e di sakt, me gjasë paske qenë kryesues i Kuvendit e që është më mirë sepse do të thotë duhet ta dish. Pastaj, para se të përmenden këto çështjet tjerat që u përmenden, tani sërish po e them që secili prej nesh këtu vetëm një dit po ti vonohet mbledhja e mbeturinave, e bënë mediatike duke e qitë në media duke thënë që nuk erdhën të më marrin bërlllogun, a që nuk e paguan hiq nuk qenka problem. Pra si pasojë e një borxhi të vjetër po sjellën tani këto ndarje që ne i kemi bërë edhe në vitin e kaluar 10,000.00€ por edhe tani këto 60,000.00€.

nuk është e rastësishme që atje qenkan kërkuar 99,500.00€, do të thotë është kërkuar që ai borxhi i 100,000.00€ që është mbet kaheerë këtu.

Nuk e kisha fjalën për ndërgjegje të gjithsecilit sepse kjo shprehje është si thënie ashtu dhe nuk deshta ashtu siç po thuhet.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, si duket edhe unë po hyjë në telashe me Kompaninë "Pastrimi" sepse do t'i mbetemi 30,000.00€ borxh, pas përfundimit të këtij mandati.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSh, duke i'u përgjigjur Kryesuesit, theksoi, ti nuk i mbetesh i nderuar Kryesues sepse është arsyeja përse është ai borxh, dhe këtë e din ish Kryesuesi i cili mund të na tregoj lidhur me këtë.

z.Fatmir Gashi, theksoi, rreth çështjes së ngritur tani po e jap përgjigjen për ty drejtor dhe për këtë Kuvend, që atëherë kemi konstatuar se po operon jo mirë Kompania "Pastrimi" dhe që duhet të ndërmerren masa dhe njëri ndër ata që e ka ngritur zërin më së shumti ke qenë pikërisht ti (i drejtohet drejtorit parafolës) për çka mund të kërkosh në procesverbale, duke na thënë që boll më me këto ndihma sepse na është krijuar si i sëmurë kështu ekonomik si konstatim.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSh, nga vendi i drejtohet parafolësit duke i thënë që ky është borxh që i keni mbet asaj Kompanie, jo ndihmë e as subvencion.

z.Fatmir Gashi, i reagon drejtorit parafolës duke i thënë që të mos i'a ndërprej fjalën më asnjëherë si dhe mos e ndez më migrofonin pa tu dhen fjala sepse nuk je ti ai që drejton seancën por është Kryesuesi i kuvendit që jep fjalën dhe që lëshon e ndal mikrofonat dikujt. Unë jam seriozë kur flas prandaj me mua jo kështu.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, drejtori parafolës nuk e përmendi dhe nuk e di përse tha borxh sepse ajo ka qenë një Memorandum i nënshkruar, nëse tani dëshiron ti shpjegohet se çka është Memorandumi i Bashkëpunimit ju tregojmë, por kontratë nuk ka pasë dhe asgjë tjetër nuk ka pasë, prandaj nuk e di përse ti drejtor po e quan borxh sepse nuk është borxh ai, por edhe nëse është

nënshkruar ai Memorandum, ti je në dijeni që këtu ndërrohen pushtetet dhe është deshtë ju ta vazhdoni dhe ta kryeni atë borxh.

z.Haki Rudari, theksoi, kolegu im paraprakisht e tha në emër të Grupit të LVV-së dhe t'ju them të drejtën unë nuk e pata ndërmend të marrë fjalën por po e shoh që krejt fajtoje këtu qenka Komuna e Prishtinës që realisht udhëhiqet nga LDK. Këtë e them sepse në arsyet që Kryeshefi i kësaj Kompanie i është drejtuar Kryetarit të komunës së Podujevës, janë katër e që unë po e përmend vetëm të dytën, dhe atë; Kërkesa për subvencionim bazohet në gjendjen financiare në të cilën është Kompania si rezultat i njoftimit të komunës së Prishtinës, jo të Podujevës, po besoj që këtë material e kanë edhe kolegët nga LDK. Pra po e përsëris; është Kompania si rezultat i Komunës së Prishtinës, po vazhdoj, për pezullimin e Rregullores për menaxhimin e mbeturinave, gjë kjo e cila është shumë me rëndësi dhe është shumë negative që e ka ndërmarrë këtë hap Prishtina e që në vazhdim thuhet që ka shkaktuar këtë konfuzion për pagesën e faturave.

Kjo është shumë e rëndësishme ku një Kuvend Komunal, në këtë rast ai i Prishtinës merr një vendim dhe shkaktonte konfuzion tek qytetarët për pagesë dhe si rezultat i mos pagesës, e tha shumë mirë drejtori parafolës, vijnë pastaj edhe grumbullimet, borxhet, dhe po ashtu e ceku shumë mirë që vetëm një ditë nëse nuk mbledhet, unë që vije nga shkolla por edhe nga amvisëritë, besoni që krijohet një gjendje shumë e rëndë, madje shkollën që e kemi këtu afër janë fëmijë dhe nxënës tanë, prandaj nëse e dini nuk e bëni këtë, ta dini që duhet ta ndihmoni dikë kur është interes i përgjithshëm e nderuara Arnisa, unë nuk po e them nga vetja këtë, por këtu e keni edhe materialin dhe kujdo mund t'ia ofroj ku thuhet fajtoje është Komuna e Prishtinës, ne nuk e kemi bërë dhe nuk e kemi ndërmarrë këtë hap, por nëse edhe ne do ta ndërmerrnim do të ishim fajtor edhe ne.

z.Naim Çunaku, theksoi, pa dashur të përsëriti atë që e debatua edhe në mbledhjen e KPF-së kur drejtori i DBF e prezantoi si kantatë të kamotshme të Kompanisë “Pastrimi” me Komunën e Podujevës e që në atë mbledhje e potencoi ashtu por që sot nuk e potencoi në fjalën e tij hyrëse por që në një formë tërthorazi po preket që jemi duke bartë pasojat të një qeverisje tjetër dhe një vendimmarrje tjetër. Në rend të parë duhet ta kuptojmë se çka është vendimmarrje dhe çka është mirëkuptim, vetëm nëse ky Kuvend merr vendim atëherë hynë në obligime, është vendim.

Po, në kohën e qeverisjes së z.Nexhmi Rudarit, fare nuk po duam t'i fshehim e as t'i minimizojmë asnjëherë, ka pasë një Memorandum Mirëkuptimi në mes Kompanisë “Pastrimi” dhe Komunës së Podujevës, por vetëm Memorandum Mirëkuptimi, do të thotë një premtim gojor ose me shkrim i atëherë Kryetarit të Komunës, përndryshe nëse duam ta banalizojmë paksa këtë temë, cilat obligime të ish Kryetarit të Komunës i jetësoni ju sot, sepse nuk është normale t'i jetësoni ngase është një tjetër subjekt politik dhe është një tjetër mentaliteti si dhe është një kulturë tjetër qeverisëse, dhe kurrfarë obligimi ligjor nuk kemi sepse po të kishim ndonjë obligim ligjor ata do të shkonin përmes përmbauesit.

Sa i përket temës tjetër që e potencoi kolegu z.Haki Rudari, është e vërtetë e madhe që Kompania “Pastrimi” në bazë të përqindjes së aksioneve që ka normale që Prishtina është Komuna kryesore që i ka aksionet më të mëdha në këtë Kompani dhe pa dashur të hyjë në konflikte politike që kanë ndodh në Komunën e Prishtinës sepse e dini që kur të jesh në bashkëqeverisje normale që ndodhin ato kurora nganjëherë nuk ecin bash mirë, dhe një subjekt tjetër e ka pas në menaxhim Kompaninë “Pastrimi” dhe qytetarët e Komunës së Prishtinës e që më vë keq që tani duhet të flas për Prishtinën mirëpo u hap tema e Prishtinës dhe po flasim për të, Komuna e Prishtinës nuk ka mund ta duroj sabotimin që është bërë në mënyrë politike nga operatori ekonomik për ta qitë keq, sipas tyre, dhe Komuna e Prishtinës e ka gjetë si zgjidhje e që është shumë më i kënaqur qytetari por edhe Komuna e Prishtinës me operator privat sesa me kompaninë “Pastrimi” sepse kjo Kompani është shndërruar në çerdhe të punësimit partiak dhe e ka hup atë afinitetin e afarizmit çfarë kish

dasht të jetë. Para rreth 3 muajve Kompania “Pastrimi” ka marrë kamionë me zero zero donacion prej Komunës së Prishtinës, por nuk deshta të hyjë në këtë, dhe posa kanë kaluar në pllacin e tyre më nuk janë funksional, pra nuk na takon neve të merremi me Komunën e Prishtinës, por kish dasht të jetë ajo që neve na obligon Komuna jonë e ka interes dhe obligim pastrimin e qytetit dhe fshatrave dhe Komuna jonë e zgjedh operatorin që i’a kryen më së lehti këto punë.

Kur kemi ndërmarrë hapa për ndërtimin e Ndërmarrjes tonë Komunale ‘Eko-Llapi’ të gjithë e kemi votuar sepse dalkadal të mundohemi që një pjesë të aktiviteteve për funksionalitet më të mirë të Komunës së Podujevës ta ndërtojmë dhe ta subvencionojmë Ndërmarrjen tonë, tani ne sërish një “dinosaurë” që nuk i dihet e ardhmja e saj ta financojmë, Kështu që zotëri Rudari, konfliktin në Komunën e Prishtinës si aksionarë me mbi 50% po besoj në atë Kompani, nuk është e jona dhe nuk mund ta zgjidhim, vërtetë ka filluar politikisht ashtu qysh po fillojnë gjithëcka në kuptimin e mbipopullimit, punësimit dhe ku di tjera çështje siç është edhe sabotimi për çështje elektorale.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, nuk e besova që do të zgjatin kaq shumë polemika rreth këtij subvencioni. Tani për gjendjen financiare të kësaj Ndërmarrje po jemi të gjithë të informuar që nuk është e mirë dhe rrezikohet edhe mbledhja e mbeturinave në qytetet tona nga obligimet të cilat i ka Kompania “Pastrimi” posaçërisht te Kompania tjetër që e bënë deponimin e mbeturinave.

U cekën dhe u vu në gojë këtu edhe çështjet të cilat rrjedhin si obligim i Komunës për ndërtimin e objektit, e vërteta është fakt se aty ka një Memorandum Mirëkuptimi për ndërtimin e objektit, mirëpo në bazë të atij Memorandumi Kompania “Pastrimi” e ka ndërtuar objektin dhe çka ka ndikuar ajo që në bazë të atij Memorandumi, pra është edhe problem i yni sepse ajo Kompani është bazuar në Memorandum sepse nuk është një institucion që e ka nënshkruar një person do si do sepse e ka nënshkruar Kryetari i Komunës, dhe tani kjo i ka shkaktuar shpenzime buxhetore Kompanisë dhe ne tani jemi duke e ndarë subvencionin e dytë për Kompaninë “Pastrimi” sepse në vitin e kaluar nëse nuk gaboj i kemi ndarë 30,000.00€ dhe tani për këtë vit po e ndajmë një buxhet prej 30,000.00€. Kjo është Kompani publike rajonale ku ne si Komunë edhe në kuptimin ligjor obligohemi që shërbimet t’i marrim nga ajo. Edhe po që se dëshirojmë të angazhojmë operator privat është një çështje, nëse nuk gaboj është neni 38 i Ligjit për prokurim publik, dhe për të zhvilluar një autoritet kontraktues një aktivitet i prokurimit duhet në radhë të parë të sigurohemi që ajo vet nuk mund ta kryej atë shërbim apo që i bie dhe nënkupton edhe ndonjë Ndërmarrje publike që është në kuadër të pronësisë së saj sepse ne jemi pronar, nuk mund ta kryej atë aktivitet.

Andaj për këtë arsye, pa dashur të hyjë në polemika me çështjet dhe vendimet e komunave tjera sepse nuk na takon neve këtu, mirëpo edhe kthimi i ligjshmërisë për vendimet të cilat janë marrë nga Komuna e Prishtinës është i bazuar në këtë nenin që unë e ceka.

Pra e ke Ndërmarrjen tënde publike e cila e kryen atë aktivitet dhe atë përmes Marrëveshjes dhe përmes procedurave të veçanta që jepet Ndërmarrjes. Mund të shpallet procedurë e prokurimit vetëm në rast se ajo Ndërmarrje nuk mund ta kryen atë shërbim, do të thotë nuk e ka kapacitetin, potencialin dhe nuk mund të zhvillohet, pa dashur të diskutoj për vullnet. Pra mbështetja ndaj kësaj Kompanie në këto momente është e domosdoshme. E thash edhe në fillim që ne po besojmë që Bordi dhe Menaxhmenti i kësaj Ndërmarrje, të tanishmit dhe të ardhshëm kush do që jenë, do të punojnë që ajo Ndërmarrje të jetë funksionale pa pasur nevojë që aksionari ta subvencionoj me mjete financiare, mirëpo është edhe çështja tjetër që shembull mbledhja e mbeturinave me koston prej 4.70 euro, edhe kjo është një çështje që është një çmim i ulët, por duke parë që është një Ndërmarrje publike ndoshta e ka këtë çmim sepse është në të mirën e qytetarëve.

z.Naim Çunaku, nga vendi theksoi, i nderuar drejtor ti në këtë rast je duke i mbrojtur interesat e Ndërmarrjes “Pastrimi”, jo të Komunës.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, vazhdoi, unë jam duke i mbrojtur interesat e qytetarëve dhe mendoj se Ndërmarrja në fjalë, përpos që është aksionare Komuna e Podujevës, Ndërmarrja dhe Komuna nuk dallojnë shumë në interesa në këtë rast, kështu që në rregull i nderuar z.Naim Çunaku, unë i dhash arsyeshmëritë, propozimi është dhe normalisht që ju i dhatë arsyeshmëritë e juaja, kurse unë ju ftoj që ta votoni, ndërsa vota normale që ju takon juve.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, besoj se dabati i zgjat paksa më shumë se sa duhet ku të gjithë të interesuarit keni diskutuar nga dy-tri herë përveç z.Bashkim Sylas i cili po e kërkon fjalën.

z.Bashkim Sylas, theksoi, debati rreth kësaj çështje u zgjerua goxha shumë ku dolëm nga Komuna e Podujevës te Komuna e Prishtinës e që nuk mundëm ta dim a ka qenë për bërlllog apo për toka të Badovcit prishja e bashkëqeverisjes atje, kështu që problemi është që ne duhet ta lëmë politikën sa i përket kësaj çështje, duhet ta shikojmë interesin e qytetarëve. Nëse ne nuk e votojmë këtë propozim vendim na mbetet bërlllogu te dera, dhe nuk paguhen ata njerëz që janë duke punuar në Kompaninë “Pastrimi”, çka po ndreqim ne me këtë punë, do të thotë po e thellojmë krizën edhe më shumë, kështu që unë mendoj se edhe kostoja e çmimit prej 4.70 euro, afër 5 euro që është e ultë, ne këtu po jetojmë dhe jemi nëm dijeni që 3-4 herë është rritur çmimi i energjisë elektrike, kurse 4.70 euro vazhdon të mbetet çmimi i mbeturinave për ekonomitë familjare. Kështu që në rast se vie ndonjë kompani private mund të ndodh që çmimin e bënë 10 ose 12 euro, andaj nuk e di pastaj cili është interesi i qytetarëve, a është ky që ta mbrojmë këtë apo ta sjellim një kompani tjetër.

Duhet ta vlerësoj Komuna se a ka llogari ta sjellim ndonjë kompani tjetër apo ka llogari të vazhdoj me këtë Kompaninë “Pastrimi”, duhet ta bëjë një plan dhe një analizë, por në këto momente ne nuk guxojmë t’ia ndalim këto mjete financiare kësaj Kompanie sepse e dëmtojmë dhe pastaj na mbulon bërlllogu këtu ku pastaj ashtu siç e përmendi dikush nga parafolësit fillojmë e bëjmë storje e postime duke u bërë horë nëpër tik-tok, facebook e rrjete tjera sociale, për çka dhe pse, për rreth 50 ose 100 vota më shumë.

Mendoj që partitë politike kur të bëjnë programe elektorale dhe kur të dalin me ide, ato që janë serioze duhet ta ngrisin nivelin pak, jo të shkohet te bërlllogu, kështu që vazhdojmë ta kryejmë këtë punë sepse nuk ja ka vlljetur të bëjmë gjë tjetër, mirëpo është vit elektoral kuptohet edhe kjo.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, sërish po e ritheksoj se debati rreth kësaj çështje u shterr dhe tani vetëm ka filluar të përsëriten gjërat.

z.Arjant Topanica, theksoi, vetëm dua të ndërlidhem me asamblistin parafolës sa i përket çmimit ngase me çmimin e njëjtë që operon Kompania publike “Pastrimi”, me të njëjti operon edhe Kompania private që është në Komunën e Podujevës, dhe kjo po arrinë që me të njëjtin çmim të ketë arsyeshmëri ekonomike dhe të kryej punë qysh duhet dhe të gjeneroj fitim sepse sigurisht që pa fitim ajo nuk punon, dhe atë me çmimin e njëjtë, kështu që nuk është arsye kur thuhet që është çmimi i ulët për Kompaninë publike në këtë rast.

z.Bashkim Sylas, përgjigje parafolësit, theksoi, i nderuar kolegë unë nuk e di veç a e kuptove që unë e thash se duhet të analizohet, unë nuk e thash 100% që është ashtu e kështu, por e thash që duhet të analizohet se a kemi më shumë llogari ta lëmë këtë qysh është apo ta sjellim një tjetër, të bëhet një analizë. Unë nuk e thash që është mirë 100% kështu, besoj se po kuptohemi.

z.Arjant Topanica, sërish lidhur me parafolësin, theksoi, të falënderoj për sqarimin koleg i nderuar, por edhe unë vetëm si analizë e thash, meqë ajo po ka arsyeshmëri ekonomike rrjedhimisht del që me të funksionon mirë ish dashtë të ketë mbulueshmëri financiare edhe Kompania publike.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, ju falëndero të gjithëve për diskutimet dhe e hedh në votim propozim vendimin sipas kësaj pike të rendit të ditës dhe materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 26 anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 16 vota Për, asnjë votë Kundër, 1 votë të Përmbajtur (të tjerët nuk morën pjesë në votim), miratohet propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare Ndërmarrjes Publike Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” Sh.A, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

4. Propozim Plan i Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSB, për vitin 2025

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, para vetës keni një Plan me kalendarin e aktiviteteve të KKSB për vitin 2025, plan i cili është përgatitur nga një Grup punues i cili është caktuar këtu në Kuvend, i cili e ka përgatitur planin e aktiviteteve të këtij Këshilli.

Pra e keni para vetës dhe e keni parë që janë paraparë 26 aktivitete të cilat duhet të zhvillohen brenda këtij viti e që realisht i bie të ndahen minimum në gjashtë mbledhje të KKSB-së që veç se janë të caktuara me ligj e që këto do të ndahen ashtu siç janë të pacaktuara edhe këtu në bazë të muajve si dhe në bazë të nevojës dhe arsyes për t’i futur në rend të ditës në secilën mbledhje, mirëpo një gjë duhet ta kemi të qartë që tema që u diskua pak më herët e që nuk po dëshiroj ta kthej at temë dhe atë diskutim, por u përmend ajo qysh e parasheh plani, është një informatë, nuk është një informatë, por një gjë duhet ta kemi parasysh se ky është një plan, nuk është raport ku ne duhet ta qesim këtu për atë që krejt ne çka kemi bërë dhe që mund ta qesim atë krejt çka kemi bërë, prandaj e them se është një plan me të cilin po planifikojmë diçka për këtë vit që kemi hyrë.

Pra edhe nëse ndonjë çështje nuk hynë në këtë plan që të përfshihet në rend të ditës në ndonjë mbledhje, nuk është tragjike sepse fundja është një plan, por që në të ardhmen varësisht nevojave mund të hyjnë edhe gjëra tjera që nuk janë paraparë në plan, del një diçka që është shumë e nevojshme për t’u debatuar në KKSB, kush çka mund të ndodh (ndonjë termet, ndonjë bombë) apo ndonjë situatë tjetër, dhe ne pastaj duhet ta debatojmë duke e lënë krejt planin anash për ta debatuar ndonjë çështje që mund të jetë e momentit.

Prandaj ju lus që ta konsideroni këtë si plan, ndërsa raportin e punës kur te sjellim e sjellim të detajuar për krejt punës që kemi bërë brenda një viti.

z.Xhevdet Maloku, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së e përkrahim këtë propozim Plan të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi - KKSB-së për vitin 2025.

z.Bashkim Sylja, theksoi, dua vetëm për korrigjim në disa pjesë të këtij Plani, konkretisht te pikat 4, 5, 6 dhe 7 nuk po e di a është gabim teknik, ku thuhet miratimi i planit vjetor të punës për vitin 2024, dhe në 5 është miratimi i planit vjetor të punës për vitin 2024 në Kuvendin e Komunës, do të thotë këtu me siguri mund të jetë ndonjë gabim teknik sa i përket vitit sepse mendoj se duhet të jetë viti 2025 e jo 2024. Përndryshe ne Grupi i PDK-së e përkrahim.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, për dallim prej parafolësit kolegut z.Bashkim Sylja unë mendoj se nuk është gabim sepse këtë Plan drejtori i DSHPMSH e tha që e kemi përgatit, është përgatit në Kuvend, mirëpo ky Plan është vetëm copy paste, do të thotë vetëm ka harruar ta bëjë vitin 2025 por ashtu qysh ka qenë në vitin 2024 e kanë lënë ashtu.

Këtu në Kuvend nuk ka raportuar askush çfarë aktivitete kanë ndërmarrë, çka kanë bërë, ka shumë gjëra që nuk i kanë bërë dhe nuk e di kur kanë ardhur ndokush e të japin raport këtu në Kuvend, kështu që ky Plan është vetëm copy-paste.

z.Naim Çunaku, theksoi, është mirë kur kemi plane dhe kemi një strategji se ku jemi dhe ku po duam të arrijmë, në veçanti kur kemi çështje që janë të një rëndësie të veçantë siç është çështja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Ajo që kam parasysh dhe që tani dua ta kundërshtoj, ngase po e kundërshtoj vetëm LVV-së, por tani në këtë rast po e kundërshtoj kolegun parafolës z.Ekrem Rrahmani për të cilin e them se nuk e ka mirë dhe arsyeja përse nuk e ka mirë besoj se pajtohet kur ta përfundoj, plani i punës 2024 dhe është kopjuar dhe ka dalë në vitin 2025, po duhet të kopjohet i nderuar Ekrem sepse nuk është bërë asgjë në 2024, dhe ai duhet të realizohet diqysh ose duhet të pritët t'i shtohet edhe ndonjë vit tjetër. A janë paraparë dhe a janë saktësuar cilat janë rreziqet potenciale që e rëndojnë ose që e atakojnë Komunën tonë, pastaj cilat janë preventivat që duhet të ndërmarrin që të mos ndodh ajo, jo, mirëpo aq është jo funksional ky Këshill, dhe jo vetëm i sotshmi të mos keqkuptohet, por është përcjellë procedurë vit pas viti prej kur është ardhë Udhëzimi përkatës Administrativ për të bërë një Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, edhe tani por edhe përpara nuk është punuar kurrëgjë në këtë drejtim por më tepër është punuar vetëm sa për ta përmbushur një obligim ligjor siç i'a përcakton ana ligjore në fuqi në Republikën e Kosovës.

Tani po dua të dalë tek një diçka që nëse jemi të sinqertë (se nuk po dua të përmendi fjalën ndërgjegje), të gjithë ne që jemi këtu e takojmë për çdo ditë veç një segment të sigurisë që e kemi sot gjithandej Komunës së Podujevës. Sigurisht që të gjithë ne e dimë transportin e nxënësve, kemi një Plan të Mobilitetit të votuar në këtë Kuvend dhe në atë Plan janë të përcaktuara saktë kriteret kush mundet dhe kush duhet ta bëjë transportin, nuk po e them këtë për politikë por po e them krejt njerëzisht se jam tmerruar kur kam parë në çfarë gjendje sot transportohen nxënësit e Komunës tonë deri të shkolla, jam tmerruar kur e kam parë kombibusin sikur të ngarkonte "lop", as karrige e as asgjë, i kish fut 20-30 nxënës në një kombibus.

Ju kisha lutë, fare politike nuk e kam, a mendoni që një aksident asifare i atij vozitësi, çfarë pasojash do të na prodhonte të gjëja më e shtrenjtë që kemi fëmijët, dhe apeloj i nderuar drejtor i DSHPMSH, fare pa politikë, te zyrtari gjegjësisht inspektori i komunikacionit që e kemi në Komunën e Podujevës, apeloj tek zyrtarët policor, apeloj te Drejtoria e Arsimit që të ndërmarrin një preventiv përderisa nuk na bëhet von dhe përderisa nuk skuqemi këtu me njëri tjetrin dhe të ndihemi keq për rastet e ndodhura e që potencialisht janë të mundshme të ndodhin, dhe në këtë rast planet janë që ata që duhet të kenë parasysh t'i preventojnë këto elemente të rrezikut në bashkësi, por jo të ndalet vetëm me funksionimin e KKSB, të delegohen kompetenca dhe të formohen edhe këshillat në bashkësitë nën komunale të cilat thuajse janë fiktive, shumë sinqerisht jua them këtë sepse çështja e sigurisë nuk është politike të nderuar dhe nuk do të duhej të jetë politike.

Vërtetë është duke na ruajtur Zoti prej rreziqeve, mirëpo duhet t'ia ndihmojmë që t'i preventojmë ato rreziqe dhe t'i minimalizojmë aq sa mundemi dhe aq sa kemi kompetenca e që me një punë më të mirëfilltë dhe me angazhimin e të gjithë neve besoj se të paktën potencialisht do t'i zvogëlonim.

z.Fatmir Gashi, theksoi, sa i përket kësaj çështje unë dëgjova me vëmendje, është çështje jashtëzakonisht e rëndësishme sa i përket këtij sektori por unë mendoj se Komuna jonë sikurse të gjitha komunat ku një pjesë dërmuese e tyre e kanë edhe Drejtorinë përkatëse që është Drejtoria për mbrojtje dhe emergjencë, por ne e kemi sektorin edhe më tutje që është sektori për emergjencë që duhet të merret me gjitha këto çështje të cilat i takojnë gjërave të shikuara dhe të parashikuara, ta bëjnë planin dhe të veprojnë mbi bazën e atij plani në rreziqet e mundshme të cilat mund t'i kanosen, përveç këtij plani që kemi sot këtu.

Ai sektor e ka për detyrë dhe për obligim që përherë të jetë në gjendje gatishmërie që të mënjanoj dhe të krijoj preventivat për mbrojtje dhe siguri të qytetarëve në Komunën tonë.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, jemi dëshmitar që fatkeqësisht në javën e kaluar në Komunën e Podujevës përmes mediave jemi njoftuar që në Shkollën “Fan S. Noli” ka ndodhur një rast i therës me thikë të një nxënësi. Konsideroj se KKSB si organ i lartë i sigurisë duhet të ndërmerr hapa dhe aktivitete konkrete për t’i parandaluar këto raste, e jo vetëm të ndalim sikurse që e pash në një vend aty në këtë dokument ku thuhet që brenda këtij viti për raport të punës së KKSB-së e që do të thotë se kemi vetëm një informatë për sigurinë në shkolla dhe asgjë më shumë, andaj konsideroj se KKSB duhet të ndërmarr edhe më shumë aktivitete për parandalimin e këtyre dukurive e jo të pritët të na ndodh ndonjë fatkeqësi shumë më e madhe sikurse rasti i vitit të kaluar që ka ndodh me 18 vjeçarin i cili është rrahur me një shufër metalike e që pastaj ka qar në vdekje atë.

Prandaj konsideroj se KKSB së bashku me Policinë dhe me psikologë si dhe me të gjithë akterët tjerë duhet të ndërmarrin masa konkrete e jo vetëm të ndalen me një informatë për gjendjen e sigurisë së nxënësve.

z.Ragip Fetahu, theksoi, vetëm deshta t’ia jap një informatë koleges znj.Donjetë Sheqiri se këtë javë në vazhdimësi në të gjitha shkollat e mesme në koordinim me Drejtorinë përkatëse janë bërë kontrole sistematike tek të gjithë nxënësit për të parandaluar këto fenomene dhe për të gjetur do të thotë armë të ndryshme të cilat mund t’i posedojnë nxënësit, vizita të cilat edhe kanë rezultuar me sukses, informacione të cilat mund të gjinden edhe te Policia e Kosovës.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, e falënderoj kolegun parafolës për këto informata, kjo që e tha ai është shumë e mirë por unë jam duke propozuar për tërë vitin, jo tani çka keni bërë.

Më vie mirë që ti si asambleist i pushtetit je i informuar por ne si opozitë jemi në terr informativ dhe këtë e them për arsye që ti në fillim të seancën nuk ishe prezent por që unë kam kërkuar, e që njëmend jemi në terr informativ sepse neve nuk na raportohet nga këta drejtor të drejtorive se çka po ndodh në Komunën tonë, ndërsa asambleistët e pushteti e din sakt se çfarë vizitash janë duke u bërë sepse i marrin informatat zyrtarisht, ndërsa nëse do t’i ishim edhe ne informatat në rrugë ligjore qysh do të duhej të vinin në Kuvend edhe unë do ta dija se janë bërë disa vizita sistematike, por prap se prap propozimi ishte për tërë vitin e j vetëm për këtë javë. Nuk duhet të pritët të ndodh një rast tragjik për të bërë pastaj aktivitete, por këto duhet të jenë vazhdueshmëri mirëpo informatat janë shumë të vogla, të pakta dhe nuk kryejnë punë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, në mbledhjen e KPF-së është kërkuar nga kolegu z.Haki Rudari që brenda vitit t’i kemi dy informata prej KKSB-së, është votuar në KPF dhe besoj se edhe sot po e votojmë që brenda vitit 2025 t’i kemi dy informata nga KKSB.

z.Ragip Fetahu, theksoi, kur jemi te informata pra është shumë e rëndësishme të potencohet se unë dhe znj.Donjetë Sheqiri kemi një dallim, jo për atë që unë jam pozitë apo ajo që është opozitë, mirëpo për atë se unë jetoj në Podujevë kurse ajo nuk jeton këtu, si dhe për atë që unë në vazhdimësi interesohem për të gjitha proceset të cilat ndodhin në Komunën tonë si dhe për çdo fenomen, për çdo çështje dhe për çdo problematikë interesohem si përfaqësues i qytetarëve dhe shkoj direkt te vendi i ngjarjes dhe e marrë informatën.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, mua më vije keq që një koleg sikurse parafolësi z.Ragip Fetahu bie në këso informatash të pavërteta. Unë banoj në fshatin Dumnicëtë Podujevës dhe këtë ai e din shumë mirë, dhe se sa kam punuar unë për të rinjtë dhe qysh jam angazhuar për të rinjtë dhe se sa i’u rri unë të rinjve afër parafolësi e din më mirë ndoshta se unë, kështu që nuk është në rregull të diskutohet dh të bie debati në këtë nivel se u jetoj unë ose ku jeton ai.

Po dua të them se edhe këta të tjerët, po e zëm që unë nuk jetoj në Podujevë, por znj.Arnisa Sylejmani, z.Naim Çunaku, dhe të tjerët jetojnë në Podujevës por që asnjëri prej nesh nuk i dim ato

informata, prandaj edhe njëherë e them se a duhet që patjetër të jesh asamblistë i LVV-së për me ditë çka po ndodh në Komunë.

znj.Arnisa Sylejmani, theksoi, sa i përket asaj se kush jeton në Podujevë, unë personalisht jetoj në Podujevë dhe si 22 vjeçare më intereson shumë të di se çka ndodh me rininë në qytetin tonë.

Nuk e konsideroj fare të mirë këtë vizitën që u tha se është bërë në javën e fundit nëpër shkolla, përkundrazi e konsideroj të keqe sepse do të thotë pasi ka ndodh rasti i therrjes së të riut në shkollën e teknikës, ata kanë shkuar në vizitë, e që konsideroj se ky është problemi në Komunën tonë që do të thotë se nuk ndërmerren masa parandaluese mirëpo vetëm pasi të ndodh diçka dhe duke e bërë 1 javë si lajm kryesor atë punë dhe merremi paksa me të, e pastaj e lëm.

Interesohemi edhe ne se çka ndodh në Komunën e Podujevës, realisht 24/7 jam në Podujevë, madje shumë pak lëvizim jashtë Podujevës, por këto informacione që po i merr kolegu z.Ragip Fetahu un nuk po di se ku t'i marrë dhe nuk po di ku të drejtohem t'i kërkoj.

z.Haki Rudari, theksoi, unë informacionet po i marrë prej materialit që na është dërguar e që është informatë zyrtare, jetoj në fshatin Shajkoc. Pasi që vije edhe nga fusha e Arsimit...

Përbërja e KKSB-së është nga disa lëmi, Policia, FSK, Drejtoria e Arsimit, drejtori z.Bahri Selimi e dinë më mirë këtë dhe mund të më korrigjoj, pastaj Shërbimet Publike, Shëndetësie dhe të tjera.

U përmend nga njëra prej kolegeve rasti i therrjes me thikë të një të riu në shkollë, po ka ndodh ai rast në Shkollën e mesme teknike, por është Policia e cila bashkëpunon me shkollën, unë vet kam punuar në këtë shkollë dhe e di që është Policia e cila është enkas për shkollat e cila bënë vizita, dhe po duhet me u marrë me këtë çështje dhe sigurisht që shkolla duhet të kujdes dhe prioritet.

E tha po ashtu kundërshtari im politik (më i forti në këtë Kuvend këtu duke i'u drejtuar z.Naim Çunakut), pra e tha çështjen e transportit të nxënësve për të cilën edhe unë e them po është e vërtetë që janë disa transporte të cilët fusin një numër të madh të nxënësve brenda, dhe seriozisht duhet të ketë kujdes dhe me këtë çështje sigurisht që duhet të ketë kujdes dhe të merret edhe Drejtoria përkatëse ose drejtorët në këtë çështje.

E thash edhe në fillim se këtu në këtë Plan është edhe kalendari i aktiviteteve, por e tha edhe drejtori i z.Bahri Selimi se mund të ketë edhe mbledhje të tjera, mund të ketë mbledhje të jashtëzakonshme apo edhe emergjente, por unë po e përsërisë edhe njëherë propozimin që e kisha në mbledhjen e KPF-së për arsye se me Rregulloren parashihet që KKSB ta informoj Kuvendin e Komunës dy herë brenda vitit, propozim të cilin e parashiroj edhe sot meqë fillimisht mendova që Kryesuesi do ta përmend vet, që në muajin korrik të jetë një informatë e KKSB-së në Kuvendin e Komunës, dhe informata e dytë të jetë diku në muajin dhjetor 2025 ose eventualisht në muajin janar 2026, kështu e parashih Rregullorja.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, mua më bëri përshtypje edhe kalendari i këtyre tryezave që parashihen në Plan e që shumica prej tyre janë paraparë në muajt shtator-tetor, andaj meqë drejtori i DSHPMSh e tha që njerëz këtu e kanë përpiluar këtë Plan, a e kanë paraparë ata që ky vit është zgjedhor dhe ata mua janë fushatë, prandaj kush mendon që ju vie dhe cila parti ju vie në tryezë sepse mendoj se të gjithë vrapojnë për vete pas fushatës dhe askujt nuk i bie në end për këtë punë. Pra shumicën e gjërave të rëndësishme që i keni lënë ju janë në muajt shtator-tetor, andaj është dashtë ta parashihni këtë që e thash.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, shikoni, për këtë pikë të rendit të ditës u debatua gati si të jetë raport i KKSB-së kështu që nuk po e zgjatim më shumë por po e hedh në votim këtë Plan të punës së KKSB-së sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, së bashku me propozimin e z.Haki Rudari që në kuadër të Planit të përfshihen edhe dy informata ose raporte të KKSB-së për Kuvendin e Komunës, dhe atë e para në muajin korrik për gjashtëmujorin e parë të

vitit dhe tjetra në muajin dhjetor për gjashtëmujorin e dytë të vitit, gjë e cila është rekomanduar edhe nga mbledhja e KKSBB-së materiali i së cilës ju është dërguar dhe e posedoni të gjithë.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 27 vota Për, nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, miratohet me vendim Plani i Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSBB, për vitin 2025, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, dhe plotësim ndryshime që në Planin përkatës, konkretisht në:

-Në majin korrik të përfshihet edhe Informatë për Kuvendin e Komunës, nga Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, për gjashtëmujorin e parë të vitit.

-Në majin dhjetor të përfshihet po ashtu edhe Informatë për Kuvendin e Komunës, nga Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, për gjashtëmujorin e dytë të vitit.

-Në disa rubrika të draft Planit ku është cekë viti 2024 si gabime teknike të zëvendësohen me vitin 2025

5. Informatë e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

znj.Lirie Hoti, drejtoresh e DBPZHR, e paraqiti informatën në fjalë, theksoi, sipas Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2025, është e paraparë dhe planifikuar që gjatë kësaj seance të jepet informatë e DBPZHR-së, andaj në vazhdim do t'ju informoj lidhur me projektet të cilat ne i kemi planifikuar t'i realizojmë përgjatë këtij viti e po ashtu do të flasë për të gjitha fazat e realizimit të këtyre projekteve si dhe punët dhe angazhimet tjera që janë kryer deri më sot brenda kësaj Drejtorie.

Fokusi kryesor i DBPZHR-së për vitin 2025 janë investimet në fushën e pemëtarisë, kryesisht në pemët e imëta, perimtarisë, blegtorisë, bletarisë, shpezëtarisë dhe mekanizmit bujqësor, andaj kur jemi te pemëtaria ne këtë vit kemi pasë të hapur thirrjen publike për përkrahjen e 10 fermerëve me fidanë të mjedrave, thirrja ka qenë e hapur nga data 21.01.2025 deri më datë 10.02.2025, ku gjatë këtij projekti është paraparë që të përkrahen 10 fermerë me nga 1100€ në formë të subvencionit si pagesë direkte dhe ditën e djeshme e kemi publikuar edhe listën përfundimtare të fermerëve përfitues, e që qëllimi kryesor i këtij projekti është ngritja e pemishteve moderne me mjedër si dhe rritja e kapaciteteve prodhuese në sektorin e pemëve të imëta që janë strategjike për Komunën tonë. Sigurisht që në këtë projekt ne kemi bërë projekt për përkrahje me fidanë të feferonave ku këtë vit është bërë përzgjedhja e 15 fermerëve përfitues për implementimin e këtij projekti të cilët do të mbështeten me nga 700€ si pagesë direkte për fermerin/en përfitues, kjo thirrje publike ka qenë e hapur nga data 16.01.2025 deri më datë 05.02.2025 dhe qëllimi kryesor i këtij projekti është mbështetja e fermerëve dhe rritja e sipërfaqeve të mbjella me perimekulturë.

Përveç kësaj, këtë vit te ky sektor kemi bërë një risi për shkak se veç përkrahjes me fidanë ne kemi bërë dhe do të bëjmë përkrahjen me subvencione për pajisje të këtij sektori ku këtë vit kemi ndarë buxhet për përkrahje me 2 pajisje përkatësisht me spërkatëse dhe gërshërë për krasitje me bateri.

Në kuadër të buxhetit të planifikuar për sektorin e pemëtarisë, veç përkrahjes me fidanë, këtë vit si Drejtori një pjesë të këtij buxheti e ka ndarë për përkrahje me pajisje për këtë sektor e cila kërkesë vazhdon të jetë në procedura të prokurimit dhe nga kjo mbështetje do të përfitojnë 45 fermer, përkatësisht 25 fermer me spërkatëse dhe 20 fermer do të përkrahen me gërshërë për krasitje.

Perimekultura është një sektor tjetër i rëndësishëm për bujqësinë në Komunën e Podujevës ku këtë vit do të vazhdon me furnizim dhe montim të serave për fermer, ku planifikohet furnizimi me 149 sera me nga 50m², 500m², dhe sera 1000m², projekt i cili është në procedura të prokurimit dhe në

këtë mënyrë planifikohet të kontribuohet në përmirësimin e kushteve të punës së fermerëve duke krijuar kushte për gjenerim të të hyrave më të mëdha dhe vetëpunësim nga aktiviteti i tyre.

Një projekt tjetër i veçantë dhe i rëndësishëm është edhe ai i furnizimit me mekanizëm bujqësor ku këtë vit planifikohet të përkrahen rreth 147 fermerë, dhe atë me këto lloje të mekanizmit bujqësor; freza 1.8, plluxh dy rendor, mbledhëse bari, motokultivator me frezë, shpërndarëse plehu 350 litërsh dhe makinë mbjellëse për lopë. Sigurish që ky projekt është iniciuar dhe është në fazat e prokurimit dhe qëllimi kryesor i tij është rritja e kapaciteteve prodhuese të kulturave bujqësore përmes përgatitjes më cilësore të tokës.

Te blegtoaria, këtë vit kemi paraparë të ndajmë buxhetin në dy pjesë ku përveç përkrahjes me mëshqerra për fermerët po planifikohet të përkrahen 162 fermerë me nga një mëshqerrë barrëse.

Po ashtu këtë vit ne kemi paraparë të vendosim subvencionim edhe për pajisje bujqësore për këtë sektor ku kemi planifikuar të subvencionojmë 10 fermerë me laktofriz dhe 5 fermer me mikser për ushqim voluminoz, pra gjithsej do të përkrahen 177 fermerë në sektorin e blegtorisë, dhe qëllimi kryesor është mbështetja e fermerëve në avansim dhe rritja e kapaciteteve prodhuese si dhe rritja e numrit të gjedheve, dhe se po ashtu edhe ky projekt është iniciuar në prokurim.

Subvencione për bletari, më saktë për këtë sektor do të bëjmë përkrahjen e fermerëve me pajisje për bletari ku javën e ardhshme do të dalë ftesa publike për aplikim të fermerëve, andaj këtë vit ne kemi paraparë që të përkrahim 15 fermerë me nga një duplikator, e që qëllimi kryesor është mbështetja e bletarëve në rritjen e kapaciteteve prodhuese të mjaltit dhe shtimi i numrit të bletëve.

Këtë vit, në kuadër të DBPZHR është vendosur të përkrahet edhe sektori i shpeztarisë ku tani janë iniciuar procedurat në prokurim dhe do të bëjmë përkrahjen e fermerëve me nga 1 pajisje për printimin e vezëve, e që qëllimi kryesor është përkrahja e fermerëve në zhvillimin dhe ngritjen e kapaciteteve në sektorin e shpeztarisë.

Përveç projekteve të planifikuara nga buxheti i Komunës për DBPZHR-në, ne kemi edhe projekte tjera të realizuara me Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-MBPZHR, ku gjatë këtij viti deri më tani kemi pasur të hapur thirrjen për aplikim për pagesa direkte për litër të qumështit sipas kategorive të cilësisë, thirrje të raportuara të gjedhit, viçat për majmëri dhe akuakulturat për 6 muajt e dytë të vitit 2024. Në kuadër të kësaj thirrje që ka qenë e hapur nga data 15.01.2025 deri më datë 24.02.2025, deri në afatin e aplikimit dhe përpilimit të këtij raporti janë pranuar gjithsej 74 aplikime të fermerëve për qumësht sipas cilësisë dhe 9 aplikime për viça sipas majmërisë, dhe të gjitha kërkesat janë proceduar tashmë në Ministri.

Pastaj projekte të realizuara në bashkëpunim me organizata, e që deri më tani kemi pasur një thirrje të hapur në bashkëpunim me KEER International, thirrje kjo që ka pas për bazë të përkrahë 24 gra fermere me këto lloj pajisjesh; pajisje për bletari, pajisje për përpunimin e qumështit, motokultivator dhe sera 50m², thirrja ka qenë e hapur për aplikim, gjithsej janë pranuar 208 aplikime dhe tani jemi në fazën e shqyrtimit të aplikimeve të fermerëve dhe shumë shpejt besoj që do të fillojmë me vlerësimet në terren.

Përveç këtyre ne kemi edhe aktivitete tjera që realizohen, siç janë kërkesat për rexhistrimin e numrit identifikues të fermerit-NIF, monitorimin në terren të subvencioneve të ndara gjatë vitit 2024 e që vlen të informoheni se në kuadër të DBPZHR kemi nxjerrë një plan për vitin 2025 për monitorimin e të gjitha subvencioneve të ndara nga kjo Drejtori dhe në baza mujore komisioni i caktuar nga kjo Drejtori është duke dalë në terren për verifikim dhe vlen të theksohet që deri më tani kemi hasur në një rast të keqpërdorimit të subvencionit të vitit 2024 lëndë kjo e cila është duke u përgatit për tu përcjellë në gjykatë pastaj. Mandej kërkesa tjera janë ato për shndërrimin apo ndërrimin e tokave, kërkesa për aplikim për subvencione dhe takime të përditshme me fermerë.

Kjo ishte për fillim, duke ju falënderuar për vëmendje, jam e hapur dhe pres pyetjet tuaja.

znj. Sebastina Vokrri, theksoi, jemi të vetëdijshëm që jemi duke jetuar në një kohë ku secilën herë jemi duke u ballafaquar me krizë ekonomike si pasojë e rritjes së çmimeve të produkteve esenciale, andaj investimi në bujqësi është një nga mënyrat efikase për të garantuar zhvillim ekonomik dhe social. Politikat mbështetëse siç janë subvencionet për fermerët dhe zhvillimi i infrastrukturës bujqësore janë thelbësore për të rritur produktivitetin dhe konkureshmërinë në këtë sektor, prandaj në emër të Grupit të LVV e falënderojmë drejtoreshën parafolëse për informatën e dhënë, dhe i urojmë sukses në arritjen e qëllimeve në realizimin e objektivave në sektorin e bujqësisë për vitin 2025.

z.Arjant Topanica, theksoi, e falënderojmë drejtoreshën e DBPZHR për informatën e dhënë dhe korrektësinë që vazhdimisht ka treguar në raport të paku me neve si asamble.

Normalisht që i përshëndesim dhe i përkrahim të gjitha nismat e mira dhe grandet që janë në të mirë të qytetarëve dhe duke shpresuar që gjithherë ato shkojnë në destinacionin e duhur dhe përdoren në mënyrën e duhur.

Dy shqetësime që kam marrë nga fermerët dhe bizneset që merren me bujqësi janë; te bizneset që kanë mbi 20 punëtor si do të mbështeten ata me mekanizëm bujqësor për arsye se mekanizmi bujqësor i paraparë të jepet në formë të grandit thuhet që është i vogël si masë, si njësi dhe nuk i përgjigjet kërkesave dhe interesave të këtyre fermerëve, si dhe e dyta një ankesë tjetër është në bashkëfinancimet e që prapë po ankohen se përqindja në bashkëfinancimin e grandave dhe ndihmesave të ndryshme që vije nga Komuna është mjaftë e lartë dhe ndonjëherë e pa përballueshme duke i bërë ata që të tërhiqen e të mos mund t'i marrin këto të mira apo grande që vijnë si mbështetje nga Komuna jonë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, së pari e falënderoj drejtoreshën e DBPZHR që është korrekte dhe vjen e ballafaqohet me pyetje dhe raportin dy herë në vit para Kuvendit. Unë pata qejf ta dëgjoj duke shpjeguar edhe njëherë lidhur me dëmet e vitit 2023, pse nuk janë marrë, nuk dua të bëjë politikë, por ta dëgjojnë edhe qytetarët saktë a do t'i marrin ato kompensime apo jo, fjala është për dëmet në ekonominë familjare dhe dëmet në bujqësi, por jo t'iu thuhet, ka shpresë, s'ka shpresë, por t'iu tregohet pse ka ngecë kjo punë.

znj.Lirie Hoti, drejtoresh e DBPZHR, theksoi, z.Arjant Topanica përmendi bizneset që kanë mbi 20 punëtor dhe është e vërtetë që në DBPZHR janë paraqitur disa kërkesa prej fermerëve që mbjellin edhe sipërfaqe më të mëdha të tokës mirëpo për shkak të këtyre kërkesave dhe takimin që e kemi mbajtur në fund të vitit 2023 me fermer dhe kërkesave që ata kanë pas ne në vitin 2024 kemi pas gjithëpërfshirje ta quaj ashtu të mekanizmit bujqësor duke subvencionuar 7 lloje të mekanizmit ku këtu ka bërë pjesë edhe mekanizmi bujqësor për sipërfaqe më të mëdha të tokës siç ka qenë makina pneumatike për mbjelljen e misrit ku ka qenë një makinë e cila i duhet një fermeri që mbjell një sipërfaqe më të madhe, e jo atyre që mbjellin sipërfaqe mesatare ose të vogël, dhe me këtë unë konsideroj që kemi bërë një gjithëpërfshirje, mirëpo buxhetin për këtë sektor që ka DBPZHR nuk mund të lejoj t'i përkrahësh gjithë fermerët, andaj fermerët me sipërfaqe më të mëdha i përkrah MBPZHR në formë të grandeve të ndryshme, por ne si Drejtori në bazë të buxhetit që kemi jemi munduar ta bëjmë një gjithëpërfshirje prapë duke i përkrahë fermerët më të mesëm dhe më të vegjël që kultivojnë sipërfaqe të tokës dhe po ashtu edhe këtë vit prapë kemi vazhduar me të njëjtën matematikë nëse mund ta quaj kështu, që edhe këtë vit e kemi bërë një gjithëpërfshirje e që këtë vit kemi 6 lloje të mekanizmit që veç e përmenda më parë.

Te bashkëfinancimi, bashkëfinancimi është votuar në Kuvendin Komunal, mendoj që ka qenë diçka pozitive në momentin kur është propozuar sepse nuk e di kush e ka propozuar a po e kujt ka qenë ideja e bashkëfinancimit të fermerëve, por edhe në shumicën e komunave tjera të Republikës së Kosovës ekziston bashkëfinancimi, andaj tani të mos ndalemi sa është përqindja e

bashkëfinancimit sepse tek ne është 30%. Unë konsideroj që në momentin kur është iniciuar kjo ka pas një qëllim pozitiv kështu që ne vazhdojmë ta përkrahim, a ka vend për ta ndryshuar kur do që të shqyrtohet ndonjëherë Rregullorja, pa tjetër ne këtu do të jemi për t'i jap propozimet tona.

Lidhur me pyetjen e z.Ekrem Rrahmani, kjo çështje dhe kjo temë është stërfolur nga të gjithë ne, e rëndësishmja është që të gjithë e kemi qëllimin që fermerët që kanë qenë të dëmtuar t'ju bëhet kompensimi i dëmit dhe mendoj që të gjithë jemi të njëjtit mendim dhe të njëjtës dëshirë, kush janë faktorët që janë duke e penguar këtë lloj të kompensimit, për besë as nuk jam personi kompetent që të flasë dhe as nuk i kam ato informacione, sigurisht unë prapë ju sugjeroj, për të mos e jap një informacion të gabuar, t'i drejtoheni komisionit përkatës për shqyrtimin e këtyre kërkesave.

z.Naim Çunaku, theksoi, edhe privatisht i thash drejtoreshës së DBPZHR se kisha dilema mes raportit dhe planit, por që të dyja e kanë plotësuar njëra tjetrën dhe në këtë drejtim jemi në rregull.

Ajo çka më bëri përshtypje dhe mendoj te subvencionimet e bujqve a kish dashtë dhe a mendoni që në një të ardhme te subvencionimi i bujqve të kalojmë prej kësaj formës të ndihmës me mjete bujqësore dhe gjëra tjera, a mendoni se sot bujku Llapjan ka nevojë për konsultime me ekspertë dhe duhet të ishin të parapara konsultimet me ekspertë, pra të kalohet prej asaj të kultivimit në bujqësi me metoda tradicionale dhe të afrohemi te një kultivim bashkëkohor që është krejt një trend tjetër, si dhe a kishim mund që në ato subvencione të kemi edhe ekspertizën e tokës së fermerëve sepse vërtetë kur kalojmë në fazën e ekspertëve duhet të dihet saktë përbërja e tokës për ta ditë cilën bimë më profitabile kish me mbjellë.

E nderuar Drejtoresh e DBPZHR, a kishe mund të na premtosh gjegjësisht ta provosh, s'po them sot sepse nuk je ajo që e merr komplet vendimmarrjen ngase e di që konsultohesh, po a kishim mund ta marrim një premtim nga DBPZHR që në ndarjen e subvencioneve në bujqësi në një të ardhme komisionet qoftë ata të mbikëqyrjes apo ata të ndarjes së subvencioneve të kenë një përbërje mikse Kuvend-Ekzekutiv, dhe kjo me qëllimin më të mirë sepse shumë Komuna e praktikojnë edhe te ndarja e bursave dhe çdo subvencion që jepet në kuptimin e transparencës që është më në nivel me vetë faktin që mendojmë se kjo është më transparente, prandaj do të doja që në një të ardhme ta kemi të paktën një komision miks qysh e kemi ngritur atëherë për verifikimin e dëmeve nga Kuvendi e që tani unë nuk po them veç nga Kuvendi por po them miks Kuvend-Ekzekutiv, dhe të shohim se këto subvencione kur t'i marrësh brenda një viti buxhetor do të arrij një shumë e caktuar dhe fundja qëllimi i subvencionimit po besoj që kish dashtë të jetë avancimi i produkteve bujqësore dhe plotësimi i nevojave të tregut të Kosovës me ato produkte që ne mund t'i kultivojmë, andaj në këtë drejtim a kishim mund që ai komision herë pas here pas një apo dy viteve të shkoj ta verifikoj gjendjen çfarë e ka subvencionin në këtë rast fermeri që e ka marrë prej Komunes, në një mënyrë që t'i eliminojmë kushtimisht po e them keqpërdorimet që mund të ndodhin dhe në një formë do të kishte një impakt te ata të vërtetit që e kemi një mekanizëm të kontrollit dhe do të ishin më të kujdesshëm për t'i shfrytëzuar beneficionet me qëllimin që e kanë marrë në rritjen e prodhimit dhe krijimin e kushteve ekonomike dhe mirëqenien.

znj.Lirie Hoti, drejtoresh e DBPZHR, theksoi, faleminderit për pyetjet e ngritura, fillimisht po e bëjë një sqarim te informata ime dhe ajo çka është dorëzuar do të thotë unë nuk pajtohem me atë që i ngjason një plani të punës, plani veç se është i publikuar në ueb faqen e Komunes, e konsideroj se një analizë shumë të thjeshtë përderisa kemi sqarime se në cilën fazë është secili projekt, nuk mund të quhet plan i punës por është një informatë, ndërkaq është mundur të realizohet për dy mujorin e parë të vitit ndërsa e planifikuar të jepet për sot nuk ka qenë nga ana ime por ka qenë nga ana e komisionit e që jeni ju këshilltarët e Kuvendit Komunal në përpilimin e planit të punës së Kuvendit, nga ana ime vetëm e kam respektuar atë që ju e keni vendos dhe kam dalë me këto informata që kemi deri në këtë fazë.

Te çështja e ngritur lidhur me llojet e subvencioneve që ne japim, konsideroj që jemi ende në fazën që fermerët Llapjan kanë nevojë që të përkrahen me subvencione të kësaj forme si te mekanizmi bujqësor me pajisje, si te blegtoaria me subvencionimin që e bëjmë për mos t'i përmendur të gjithë sektorët tjerë, mirëpo a mund të shtohet edhe një projekt tjetër që të mbajmë trajnime nga ekspertë lidhur me analizën e tokës, pa tjetër që kjo është e mirëpritur dhe mund të rishikohet kur të bëhet planifikimi për projektet e vitit 2026, mirëpo edhe te kjo dua të përmend që ne në vazhdimësi hiç më larg para dy dite kemi pas një trajnim nga MBPZHR kështu që gjatë vitit ne mbajmë disa trajnime me radhë të cilat nga kjo Ministri financohen për fermerët me tema të ndryshme që janë më të rëndësishme për secilën periudhë e pastaj kemi edhe zyrtarët e DBPZHR të cilët i kanë të përfunduar edhe studimet nëpër fushat përkatëse që çdo herë janë të gatshëm për të dalë në terren, por edhe për t'ju japë përgjigje në pyetjet që ngrisin fermerët.

Sa i përket komisionit, unë nuk mund të japë sot një premtim pa e analizuar fillimisht Rregulloren se a parashihet diçka e tillë, por a do ta analizojë këtë që ju e thatë pa tjetër që po sepse ne jemi duke filluar nga Kryetari e deri te ne Ekzekutivi, pjesa tjetër jemi shumë të gatshëm dhe e mirëpresim bashkëpunimin për gjithçka që bëhet fjalë për të mirën e përgjithshme e për të mirën e fermerit në këtë rast. Ndërsa te monitorimi i subvencioneve dhe mënyra qysh ato janë duke u përdorur, unë ju tregova që kam ngritë një komision për monitorimin e subvencioneve që kemi dhënë vitin e kaluar në të gjitha sektorët dhe me këtë mendoj që ngritët një vetëdijesim i fermerëve që ne jemi duke i monitoruar në vazhdimësi edhe për mënyrën se si janë duke i përdorur dhe çka janë duke pasur të mira prej këtyre subvencioneve. Në fund të vitit 2025 unë do e nxjerrë edhe një raport nga ajo se si ka ndikuar në përmirësimin e zhvillimit të bujqësisë dhe aktivitetit të fermerëve për subvencionet që ne kemi jep për vitin paraprak.

z.Naim Çunaku, theksoi, e nderuar drejtoresh e DBPZHR, në kuptimin pozitiv ta thashë për raport por tani po mundohem në atë anën profesionale të bëjë dallimin çka është plani i punës dhe çka është raporti, po të ishte paraparë nga buxheti i Komunës kodi buxhetor për subvencione dhe kodi buxhetor për DBPZHR, dhe po të flisnim vetëm për tre muaj ka qenë raport. Pra në atë moment që ti del dhe shpjegon dhe në atë moment që ti shkruan në raport që me këtë datë e kemi bërë këtë, e kam paraparë këtë, mirëpo raporti është çka ke punuar e jo çka ke për të punuar, prandaj mendoj që si të thuash çka ke me punuar është plan. Mirëpo është gjëja më e vogël e mundshme dhe nuk mora përgjigje për gatishmërinë për komision miks, unë të dëgjova me vëmendje kur e potencova që ne kemi komision, por shtrohet pyetja kur po kemi deformime dhe po kërkohet vendimi i Kuvendit, pse duhet të jetë i përjashtuar Kuvendi sepse fundja i heq dilemat politike nëse është komisioni miks Kuvend-Ekzekutiv ngase ne të gjithë dimë të flasim që në lagjen time një kushëri i imi, një komshi i imi, një dajë i imi, një i afërm i imi e ka marrë lopën, pastaj se ka, e ka, prandaj ai komision me përbërje prej Kuvendit miks prej të gjitha grupimeve është më kredibil në kuptimin për të mos i fshehtë ato maniverzimet që mund të rrëshqasin, jo me qëllim të benefitet gjegjësisht të përfituesit e subvencioneve.

znj.Lirie Hoti, drejtoresh e DBPZHR, theksoi, unë e vlerësoj punën që e bënë secili komision i ngritur prej DBPZHR të cilën unë e përfaqësoj dhe nuk vë asnjë dyshim te profesionalizmi i tyre por as nuk e kundërshtojmë atë dhe propozimin e juaj që të bëhet një komision i përzier, nëse një Rregullore e parasheh një gjë të tillë ne nuk jemi kundër. Unë e thash edhe paraprakisht që ne do ta analizojmë një gjë të tillë dhe do të shohim se a parashihet me ligj kjo gjë si dhe me Rregullore dhe pastaj do të marrim hapat tjerë për të vepruar, ndërsa lidhur me informatën të cilën e dhashë sot para Kuvendit unë nuk fola vetëm për projektet të cilat kemi paraparë t'i realizojmë por fola për to dhe tregova se në çfarë faze kemi arritur t'i realizojmë deri më tani, kështu që për të gjitha

projektet e planifikuara është dashur të flitet për to sepse për të gjitha i kam iniciuar procedurat në prokurim dhe ajo është bërë deri më sot për të gjitha.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, informata nuk votohet, prandaj e konsideroj se debati dhe rrjedhimisht edhe kjo pikë e rendit të ditës përfundoj.

Kryesuesi i Kuvendit e konstatoj të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës.

6. Të Ndryshme

z.Naim Çunaku, theksoi, krejt miqësisht po e them që kur subjekti opozitar në këtë rast LDK shkakua i pozicioneve politike e ushtron edhe mandatin e saj edhe politik edhe po ndodh të dalim prej sallës, a e merrni me mend çfarë “Luftë” po bëhet duke thënë e lëshuan sallën e të tjera, por sa e sa herë mbledhjet apo kuorumi dështojnë nga Grupi i cili është përgjegjës për kuorum, kjo vërtetë është për t’u gjykuar, por fundja ashtu qysh e tha më herët z.Avni Fetahu, këta edhe humbin politikisht kështu, por fundja të mbetet ashtu siç duan.

I nderuar drejtor i DKA-së, deri sa ti nuk ishte prezent këtu në sallë dhe ishim duke e trajtuar Planin e punës së KKS-së, vërtetë tani po ju shtoj pyetje zyrtarisht, a mendon që në një të ardhme të afërt të futni mekanizmat e kontrollit, qoftë inspektori i komunikacionit, përfaqësuesi i DKA-së, zyrtarë policor, dhe të bëjnë një kontrollë se në çfarë forme janë duke u transportuar nxënësit.

Për këtë çështje e thash edhe më parë se hiq politike nuk ka por krejt njerëzore, arsyeja ishte po na ndodhi që potencialisht në formën çfarë janë duke u transportuar nxënësit, është e mundshme dhe potencialisht ekziston rreziku të na ndodh ndonjë fatkeqësi me fëmijët tanë, dhe në atë rast drejtpërdrejt do të atakohesh ti drejtor sepse në rast se ndodh diçka me nxënësit adresë e drejtpërdrejtë është Drejtoria e Arsimit, prandaj në këtë drejtim do të doja t’i ushtroje të gjitha kompetencat e juaja, pa të keqe qoftë edhe miqësore qoftë edhe zyrtare, se një gjendje e tillë është e pa tolerueshme deh sa më shpejt aq më mirë, krejt me qëllimin që t’i ikim një rreziku potencial që mund të na ndodh me nxënësit.

znj.Arnisa Sylejmani, theksoi, të nderuar qytetarë, serioziteti i kësaj qeverisje për të mirën tuaj shihet qartë, nga 12 drejtor vetëm 2 janë prezent, nga 13 asamblistë të pozitës vetëm 5 janë prezent në këtë pikë. Pika e rendi të ditës Të Ndryshme, është pika ku të gjitha çështjet që i shqetësojnë qytetarët e Komunës së Podujevës adresohen por që në 90% të rasteve nuk marrin asnjë përgjigje, andaj ky është serioziteti i kësaj qeverisje.

Tani kam një pyetje për të cilën do të doja një sqarim prej drejtorit të Drejtorisë përkatëse por që nuk është prezent, mirëpo para disa ditëve patëm një vdekje të një qytetareje nga frika prej qenve endacak, andaj a mund ta dimë si është gjendja me qentë endacak në qytetin tonë.

Gjithashtu kam edhe një pyetje për drejtorin e DKA-së meqë është prezent këtu, dua të di përse në bursat e Komunës nuk po përfshihen të paktën klasët e XII-ta e që mendoj se do të ishte një shtytëse e mirë për ata nxënës që të marrin një bursë edhe nëse është ajo simbolike.

z.Florent Hasani, theksoi, bëhet fjalë për Lagjen “Te Çuka” në fshatin Brainë, rr.”Ismajl Xhela” ku banorët që jetojnë në atë rrugë ka kohë që kanë bërë kërkesën për asfaltimin e asaj rruge e cila duket qartë se ka nevojë të madhe për asfaltim, prandaj kërkojmë që të ndërmerren hapat e nevojshëm për realizmin e atij projekti.

z.Arjant Topanica, theksoi, kam një çështje që ka të bëjë me fshatin Sfeçël prej nga vijë unë, dhe lidhet me Drejtorinë e Urbanizmit në të cilën është bërë një kërkesë që rreth 1 vit e këndeje, madje edhe unë e kam bërë edhe njëherë për tu asfaltuar disa rrugë të cilat janë të paasfaltuara por vetëm me zhavorr, pra rrugë të cilat kanë kërkuar bujqit sepse janë kryesisht rrugë të cilat të dërgojnë tek

arat ku ata i punojnë e që po kanë probleme me lëvizë me mjete për të shkuar gjatë procesit të mbjelljeve por edhe pastaj për të tërhequr produktet finale, andaj kërkoj të ketë në konsideratë këtë drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit sepse këtë kërkesë e kamë bërë unë, pastaj e kanë bërë edhe bujqit. Përndryshe mund të dalin t'i shohim vendet / rrugët, madje edhe bashkërisht me bujqit mund të vizitohen ato rrugë të cilat kryesisht janë me gjatësi të shkurtër e të cilat kanë nevojë të shtrohen vetëm me zhavorr për arsye që t'ju lehtësohet operimi bujqve.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, drejtori i DSHPMSh nuk qenka prezent këtu por qenka drejtori i DKA-së, andaj e kam potencuar edhe njëherë dhe po e ri potencoj çështjen e transportit të nxënësve në fshatin Siboc, çështje kjo e cila nuk ka të bëjë me vetëm nxënësit por një kompani e cila ka qenë aty për shumë vite është tërheqë dhe tani ne kemi mbet, madje ne disa që jemi goxha largë në pjesën e poshtme ku janë mbi 2 km, prandaj pyes përse nuk po bëhet transporti, a nuk ka operator të interesuar, a nuk po jepet leja apo çka është në pyetje.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, sa për seriozitet po shihet që veç 3 asamblastë të LVV-së janë në sallë e që po besoj që edhe ata të tjerët vetëm janë nënshkruar për t'i marrë mëditjet dhe me ik, ashtu qysh ka potencuar drejtori i Drejtorisë së Arsimit, por nuk po dua të ndalem në atë.

Ne në fakt po e vazhdojmë seancën edhe pa pasë kuorum për arsye se nuk po kemi se kur t'i shprehim kërkesat tona sepse as drejtorët por as asamblastët e pushteti nuk po janë në gjendje t'i diskutojnë dhe të përballen me diskutimet tona.

Me këtë rast unë e kam një kërkesë, kjo vajza siç e shihni në foto (prezanton një foto të një vajze) është në klasën e V-të në shkollën e fshatit Llaushë të Komunës së Podujevës, dhe kjo është gjendja se qysh ajo shkon në shkollë, do të thotë kjo është rruga nëpër të cilën ajo kalon.

Ky pushtet gjatë kësaj fushate zgjedhore që lam pas ka shtruar rrugë dhe nuk ka lënë rrugë pa shtruar, madje edhe nëpër shtëpi ju ka shtruar aktivistëve të tyre, kështu që kërkoj nga Drejtoria përkatëse që sa më parë të ndërmarr hapa dhe ta shtroj atë rrugë.

Gjithashtu kam pas kërkesë edhe më parë për rrugën "Avdyl Dushkolli" po ashtu në fshatin Llaushë e cila bazën e ka që 3 vite por që për arsye politike nuk është shtruar, andaj kërkoj që këto rrugë të merren me seriozitet të trajtohen si kërkesa dhe të realizohen.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, besoj se pyetjeve tuaja do t'ju përgjigjen me shkrim drejtorët e Drejtorive përkatëse, apo do të jepen në mbledhjen e ardhshme, përndryshe po e shihni se nuk ka kuorum për të vazhduar me mbledhjen por meqë po insistoni, urdhëroni fjalën i'a jap drejtorit të Drejtorisë së Arsimit i cili është prezent për t'ju kthyer disa përgjigje apo sqarime që ishin të drejtuara për këtë Drejtori.

z.Avni Fetahu, drejtor i DKA, theksoi, sa i përket transportit të nxënësve i nderuar z.Naim Çunaku prej 11 linjave që i kemi si Drejtori e Arsimit që na takon, në distancë 4 km, ato i menaxhojmë, ndërsa çështjen që e potencuat ju pajtohem plotësisht me ty dhe ke plotësisht të drejtë. Është e drejtë ekskluzive e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe Drejtorisë së Inspeksionit, duke përfshirë edhe çështjen e potencuar nga z.Ekrem Rrahmani për të cilën jam i njoftuar sakt me atë ngjarje për të cilën ke të drejtë që është tërheqë operatori ekonomik e që në atë moment që është tërheqë është dashtë t'ia heqim edhe vijat tjera ngase nuk ka ashtu, kjo vijë po më pëlqen, në këtë ka llogari, por do të thotë duhet të jetë i barabartë për secilin.

Sa i përket bursave të Komunës, e respektuara asambleiste znj.Arsnisa Sylejmani kemi pas një përvojë kur patëm bërë një shpallëj, dhe ne jemi në dijeni qysh është gjendja në Komunën tonë, dhe kanë qenë rreth 90% e tyre me sukses 5-she e që është e pamundshme me këtë buxhet ta mbulojmë, mirëpo ajo çka kemi bërë është se ata nxënës të cilët janë të dalluar kanë bërë kërkesë dhe janë kompensuar me një vlerë financiare prej 300 euro deri në 500 euro kur kanë arritur një garë të caktuar secili prej tyre, atë kemi mund ta realizojmë.

Edhe njëherë ajo që e ceka sa i përket transportit duhet ta kemi të qartë rreth asaj problematike..

z.Naim Çunaku, nga vendi i drejtohet drejtorit parafolës, thekson, duke u lutur të mos e bëjë Zoti që të ndodh, por ata akterë do të fshihen kurse ti drejtor do të jesh temë sepse nxënës janë ata, dhe për ata të kërkoja të shfrytëzosh krejt mekanizmat

z.Avni Fetahu, drejtor i DKA, vazhdoi, vetëm një sqarim për ta bërë, operatorët ekonomik së bashku me prindërit e nxënësve po ndodh që po koordinohen për bartjen e nxënësve e që ligjërisht nuk mund t'iu ndalohej sepse ata vet po e paguajnë dhe po harmonizohen për bartjen e nxënësve, madje ka raste edhe për 1 km e nganjëherë edhe 500 metra, e që dorën në zemër për shëndetin e fëmijës më mirë është të ecin këmbë në atë distancë të shkurtër se sa ta ngarkojnë edhe komunikacionin por edhe transportin në fjalë, do të thotë ne nuk kemi kompetencë në këtë, por a na bie barra në aspektin moral pajtohem plotësisht me ty zotëri Çunaku sepse unë pastaj duhet të merrem me ata ngase janë nxënës, mirëpo është mirë që krahas kësaj edhe vetëdija e njerëzve dhe e atyre që i kryejnë këto pagesa te ata operator ekonomik të mos pranojnë që fëmijën e tyre ta fusin në situata të tilla.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, kërkoj falje, mirëpo meqenëse është diçka që ndodhi tani, drejtori i DKA-së më herët nuk ishte në sallë por meqë tani është prezent, po e shfrytëzoj që t'i drejtohem edhe këtij që në javën e kaluar jemi informuar prej mediave që në shkollën teknike është therrë me thikë një nga nxënësit në një përleshje mes tyre që ka qenë, kurs tani rasti më i freskët është që momentalisht në Shkollën "DR Ibrahim Rugova" po ashtu ka ndodh një përleshje, do të thotë në këta minuta që po flasim. A mund ta dim i nderuar drejtor se kur do ta sjellësh një raport për të na treguar qysh është gjendja, çka po bëhet, pse po ndodhin kaq shumë raste dhe se çfarë është duke bërë Komuna për parandalim e tyre.

z.Avni Fetahu, drejtor i DKA, theksoi, fillimisht ta keni parasysh faktin që nuk janë duke ndodh këto raste, për fat të mirë janë reduktuar shumë, mirëpo raste ndodhin, madje edhe tani sa jam duke diskutuar mund të ndodh. Ka ndodh në shkollën ekonomike, pastaj në shkollën teknike, nxënësit janë suspenduar, fati ka qenë i mirë që nuk ka qenë therrje e nivelit të rëndës, por për ata janë organet e shkollës, janë organet e policisë, janë prokurorët. Ka raste te shkolla ekonomike ku para dy ditëve edhe i kanë dërguar në mbajtje edhe përkundër moshës që kanë nën 18 vite, kështu që secili e kryen punën e vet.

Këto gjëra kanë ndodh edhe më parë, por për fat të mirë janë reduktuar

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, i nderuar drejtor i DKA-së, unë shtrova pyetje se çka është duke bërë DKA për t'i parandaluar këtë gjëra sepse për raste tragjike ne jemi në dijeni shumë mirë, sidomos për rastin tragjik që ka ndodh në muajin janar të vitit të kaluar e që ka rezultuar me vdekje, është rrahur me shufër metalike dhe ka shpie në vdekje, kështu që nuk do të thotë që patjetër të ketë një rast për të ndërmarrë masa pastaj.

Pyetja ime ishte konkrete, për t'i parandaluar, a jeni duke marrë masa, e jo pasi që po ndodhin pastaj kush po merret me ata.

z.Avni Fetahu, drejtor i DKA, duke i'u përgjigjur parafolëses theksoj, a jeni e vetëdijshme që ai rast që ti e përmende nuk ka ndodh në shkollë.

znj.Donjetë Sheqiri, sërish theksoi, rasti i cekur ka nisë në shkollë, dhe ju jeni i vetëdijshëm që pastaj është marrë një vendim politik për ndalimin e përdorimit të telefonëve nëpër shkolla vetëm sa për ta mbuluar mediatik, dhe telefonist prap përdorën.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, edhe kjo pikë e rendit të ditës përfundoi, kështu që ju falënderoj për angazhimin e juaj, shihemi në mbledhjen e ardhshme. Këtu e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Meqë nuk patë të lajmëruar të tjerë për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30

**Procesverbalin e mbajti dhe hartoi;
Enis Sheholli**

**Nr.Prot.01-060/04-0015027/25
Podujevë,
13 mars 2025**

**Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha**



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronjat h) i ndërlidhur me nenin 40.2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 27 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr.03/L-048 dhe nenit 34 parag. 2.3 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.01-020/01-0050862/18, Kuvendit të Komunës, i;

PROPOZON

VENDIM

PËR BARTJEN E TË HYRAVE VETANAKE TË KOMUNËS SË PODUJEVËS NGA VITI 2024 NË VITIN 2025 DHE DESTINIMIN NË KATEGORI DHE PROGRAME TË CAKTUARA BUXHETORE

Neni 1

1. Të hyrat vetanake të Komunës së Podujevës, të pashpenzuara në vitin 2024, në shumën e gjithmbarshme 890,001.09€, nga e cila prej 413,539.00€ është tejkalim i të hyrave vetanake të planifikuara në vitin 2024, barten në vitin 2025 në programet dhe kategoritë ekonomike si në vijim:

Në kategorinë e shpenzime kapitale, në nën programet si ne vijim:

1. **66030-Planifikim Hapsinor dhe Rregullativ, kodi funksional- 0620**, në projektet si në vijim:

- Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Shtedim, kodi-49273, shuma.....10,000.00 €
- Asfaltimi i rrugëve në fshatin Balloc, kodi-54730, shuma..... 20,000.00 €
- Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Sibofc, kodi-49255, shuma.....10,000.00 €
- Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Gllamnik. Kodi-46956, shuma... ..10,000.00 €
- Ndërtimi i rrugëve në fshatin Lluzhan, kodi-50612, shuma..... 10,000.00 €
- Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Shakovicë, kodi-43146, shuma..... 20,000.00 €
- Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Shajkofc, kodi-46167, shuma..... 20,000.00 €
- Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Sfeqël, kodi-46156, shuma..... 10,000.00 €
- Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Repë, kodi-54733, shuma..... 20,000.00 €
- Asfaltimi i rrugëve në fshatin Tërnavicë, kodi-54741, shuma..... 20,000.00 €
- Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Doberdol, kodi-49494, shuma..... 10,000.00€
- Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Gërdofc, kodi-49278, shuma..... 8,000.00 €

Gjithsejt..... 168,000.00 €

Arsyetim:

Projektet të cila barten në programin 66030-Planifikim Hapësinor dhe Rregullativ nga të hyrat vetanake në të gjitha projektet, janë obligime kontraktuale andaj është e

domosdoshme qe mjetet ne vlere 168,000.00 euro të barten në programin 66030 ne kodet e projekteve të cilat janë te specifikuar më lartë.

- 18165-Infrastruktur Publike, kodi funksional-0451, në projektet si në vijim:

-Ndërtimi i stacionit të udhëtarve kodi 40280, shuma.....	123,432.50 €
- Ndërtimi i kanalizimit nga fshati Lluzhan-Lupq, Gërdoc-Lluzhan dhe Majac-Lupq-Kolektori, kodi- 54483, shuma.....	114,000.00 €
- Zgjerimi dhe rregullimi i shtratit të Lumit Llap ne Qytet, kodi-52909, shuma.....	70,000.00 €
Gjithesëjt.....	307,432.50 €

Arsyetim:

Projektet të cila barten në programin 18165-Infrastruktura Publike nga të hyrat vetanake në të gjitha projektet, janë obligime kontraktuale andaj është e domosdoshme qe mjetet ne vlere 307,432.50 euro të barten në programin 18165 ne kodet e projekteve të cilat janë te specifikuar më lartë.

-93120- Arsim Fillor, kodi funksional- 0912, në projektet si në vijim:

- Ndërtimi i shkollës fillore ne fshatin Shajkoc, kodi-54258, shuma.....	200,000.00 €
- Ndërtimi i aneksit të shkollës "Ibrahim Rugova", kodi-55887, shuma.....	50,000.00 €
- Ndërtimi i aneksit të shkollës "Enver Maloku", kodi-55896, shuma.....	50,000.00 €
- Ndërtimi i aneksit të shkollës " Xheladin Rekalu", kodi-55899, shuma.....	50,000.00 €
Gjithesëjt.....	350,000.00 €

Arsyetim:

Projektet të cilat barten ne programin e Arsimit Fillor-93120 ne vlere totale 350,000.00 euro, nga këto projekti “ Ndërtimi i shkollës fillore në fshatin Shajkoc”-54258 është obligim kontraktual ku këto mjete nevojiten për realizimin e projektit të kontraktuar. Ndërsa tri projektet e tjera Ndërtimi i aneksit të shkollës "Ibrahim Rugova", kodi-55887, Ndërtimi i aneksit të shkollës "Enver Maloku", kodi-55896, Ndërtimi i aneksit të shkollës " Xheladin Rekalu", kodi-55899 janë projekte të cilat janë të planifikuara në vitin 2026, mirëpo këto mjete të planifikuara për vitin 2025 nga bartja e të hyrave vetanake nevojiten për fillimin e projekteve.

**Kryetari i Komunës
Shpetim Bulliqi**



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

DREJTORIA E BUXHETIT DHE FINANCIVE

Në bazë të nenit 13 paragrafi 1.1 të Rregullores MAPL nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës, ndërlidhur me nenet 62.3, 11; 12.2 shkronja d) dhe 40.2 shkronja c) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, neneve 17; 38; 60 dhe 61 të Ligjit nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nenit 64 paragrafi 4, neneve 14; 15 paragrafi 2.4 dhe nenin 34 paragrafi 2.3 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendit të Komunës së Podujevës, i,

Propozohet

VENDIM

PËR SHTIM TË BUXHETIT DHE KOD TË RI

Neni 1

Me këtë vendim miratohet shtimi i buxhetit dhe krijimi i kodit të ri buxhetor për projektin "Furnizim për projektin e shpeztarisë " në vlerë 9,000.00€, në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere.

Neni 2

Projekti mund të krijohet nga mjetet e participimit të qytetarëve bazuar në Marrëveshjet e Mirëkuptimit në mes Komunës dhe përfituesve të subvencionit.

Neni 3

Komuna e Podujevës si bartëse e projektit në vlerë të përgjithshme prej 30,000.00€, financon shumën 21,000.00€ apo 70% të vlerës së projektit të cekur, kurse shumata e përgjithshme e participimit nga ana e përfituesve është në vlerë 9,000.00€ apo 30% e vlerës së projektit.

Neni 4

Projekti sipas nenit 1 të këtij vendimi mbulohet me mjete financiar nga participimi prej 30% të vlerës së përgjithshme nga ana e përfituesve, ndërsa 70% të vlerës së përgjithshme nga Komuna e Podujevës, dhe i njëjti bënë pjesë në kategorinë subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – kodi i programit 47005

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe publikimit në web faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave me plotësim ndryshimet e bëre me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.prot. 01-400/01-0019657/25
Podujevë, datë: 07.09.2025



Drejtori
Fatlum Osmani



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

DREJTORIA E BUXHETIT DHE FINANCIVE

Në bazë të nenit 13 paragrafi 1.1 të Rregullores MAPL nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës, ndërlidhur me nenet 62.3, 11; 12.2 shkronja d) dhe 40.2 shkronja c) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, neneve 17; 38; 60 dhe 61 të Ligjit nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nenit 64 paragrafi 4, neneve 14; 15 paragrafi 2.4 dhe nenin 34 paragrafi 2.3 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendit të Komunës së Podujevës, i,

Propozohet

VENDIM

PËR SHTIM TË BUXHETIT DHE KOD TË RI

Neni 1

Me këtë vendim miratohet shtimi i buxhetit dhe krijimi i kodit të ri buxhetor për projektin "Furnizim për pemëtari" në vlerë 5,625.00€, në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere.

Neni 2

Projekti mund të krijohet nga mjetet e participimit të qytetarëve bazuar në Marrëveshjet e Mirëkuptimit në mes Komunës dhe përfituesve të subvencionit.

Neni 3

Komuna e Podujevës si bartëse e projektit në vlerë të përgjithshme prej 18,750.00€, financon shumën 13,125.00€ apo 70% të vlerës së projektit të cekur, kurse shumata e përgjithshme e participimit nga ana e përfituesve është në vlerë 5,625.00€ apo 30% e vlerës së projektit.

Neni 4

Projekti sipas nenit 1 të këtij vendimi mbulohet me mjete financiar nga participimi prej 30% të vlerës së përgjithshme nga ana e përfituesve, ndërsa 70% të vlerës së përgjithshme nga Komuna e Podujevës, dhe i njëjti bënë pjesë në kategorinë subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – kodi i programit 47005

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe publikimit në web faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave me plotësim ndryshimet e bëre me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.prot. 01-400/01-0019661/25
Podujevë, datë: 07.04.2025



Drejtori
Fatlum Osmani



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

DREJTORIA E BUXHETIT DHE FINANCIVE

Në bazë të nenit 13 paragrafi 1.1 të Rregullores MAPL nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, ndërlidhur me nenet 62.3, 11; 12.2 shkronja d) dhe 40.2 shkronja c) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, neneve 17; 38; 60 dhe 61 të Ligjit nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nenit 64 paragrafi 4, neneve 14; 15 paragrafi 2.4 dhe nenin 34 paragrafi 2.3 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendit të Komunës së Podujevës, i,

Propozohet

VENDIM

PËR SHTIM TË BUXHETIT DHE KOD TË RI

Neni 1

Me këtë vendim miratohet shtimi i buxhetit dhe krijimi i kodit të ri buxhetor për projektin "Furnizim me pajisje për bletë" në vlerë 6,666.66€, në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere.

Neni 2

Projekti mund të krijohet nga mjetet e participimit të qytetarëve bazuar në Marrëveshjet e Mirëkuptimit në mes Komunës dhe përfituesve të subvencionit.

Neni 3

Komuna e Podujevës si bartëse e projektit në vlerë të përgjithshme prej 22,222.20€, financon shumën 15,555.54€ apo 70% të vlerës së projektit të cekur, kurse shumën e përgjithshme të participimit nga ana e përfituesve është në vlerë 6,666.66€ apo 30% të vlerës së projektit.

Neni 4

Projekti sipas nenit 1 të këtij vendimi mbulohet me mjete financiar nga participimi prej 30% të vlerës së përgjithshme nga ana e përfituesve, ndërsa 70% të vlerës së përgjithshme nga Komuna e Podujevës, dhe i njëjti bënë pjesë në kategorinë subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – kodi i programit 47005

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe publikimit në web faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave me plotësim ndryshimet e bëre me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.prot. 01-401/01-0019659/25
Podujevë, datë: 07-04-2025



Drejtori
Fatlum Osmani



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Podujevës
Opština Podujevo – Municipality of Podujeva



Raporti Vjetor Financiar

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

Neni 13

Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme

Pasqyra e pranimeve dhe pagesave të parave të gatshme për Komunen e Podujeves
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor

|--|

Totali i shpenzimeve per periudhen janar-dhjetor 2024 eshte 33,438,931 €. Prej tyre 30,628,031€ nga Granti Qeveritar ; 2,487,002 euro nga te hyrat vetanake(1,445,342 euro nga te hyrat e vitit 2024 , si dhe 1,041,659 euro nga te hyrat e bartura). Nga grantet e percaktuara te donatoreve jane shpenzuar 277,177 euro si dhe nga huamartjet jane shpenzuar 46,720 euro.

Per paga dhe medijte jane shpenzuar 18,187,621 €, per mallera dhe sherbime 3,413,317 €, per shpenzime komunale 548,117 €, per subvencione dhe transfere 1,975,239 € dhe per shpenzime kapitale jane shpenzuar 9,314,637 €.

Raporti i ekzekutimit te buxhetit

**Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale për Komunen e Podujevës
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024**

Page 4 nga 39

Te tabela e buxhetit fillestar te pjesa e hyrjes se parase se gatshme kolona C, buxheti fillesatar per te hyrat vetanake eshte 1,859,659 € (te hyrat tatimore te planifikuara 848,995 € si dhe ato jo tatimore 1,011,664 €)gjithashtu edhe buxheti final per te hyrat vetanake eshte i njejte dmth nuk kemi pasur rishikim ne planifikim. Realizimi i te hyrave tatimore eshte 347,163 € si dhe realizimi i te hyrave jo tatimore eshte 1,363,731 €. Te donacionet buxheti per vitin 2024 eshte 309,548 €, donacione te bartura i kemi pasur 189,069 € .e qe ne total donacionet kane gene 498,618 .

Buxheti fillestar per vitin 2024 ka gene 31,268,469 (31,043,019 € dhe klauzola per investime 225,450), buxheti final 34,540,225 €, si dhe realizimi i buxhetit 33,438,931 €. Shtesat nga qeveria per paga kane gene 1,669,332 euro, mjetet nga klauzola per investime kapitale 225,450 euro, te hyrat e bartura 1,103,805 euro dhe mjetet nga donacionet 498,618 euro.

Shenim sqarues lidhur me donacionet dhe grantet

Te kolona A eshte paraqitur donacioni per vitin 2024,duke mos perfshire mjetet e bartura.

Mjetet e bartura nga donacionet jane 189,069 € dhe ate nga fondi 31 donacion i brendshem shuma 188,548 €, fondi 49 EU 420.75 €,fondi 93 Council of Europe 0.89€ dhe KAD fondi 98 shuma 100 €.

Shuma e donacioneve te brendshme prej 17,574 euro, nuk figuron ne sistem tek tabela e buxhetit si e hyre nga donacionet sepse nuk ka gene e alokuar.

Donacionet per vitin 2024 jane 327,122.43 euro.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

Shënimi 1

1. Politikat kontabël

Pasqyrat Financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të vitit 2017 "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme", i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063, Ligjin nr. 05/L-007 dhe Ligjin 08/L-183 Për mbështetjen e punëve publike.

(OB në vazhdim të tregoj politikat kontabël dhe zbatimin e rregullave për menaxhim financiar dhe kontroll).

1.1 Informata për organizatën buxhetore (aktivitetet, legjislacioni, etj)

Entitet i sektorit publik Komuna e Podujeves ka përgatitur Pasqyrat Financiare në harmoni me kërkesat e Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007.

Sipas LMFPF të gjitha transaksionet me fonde brenda Fondit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës behën përmes Llogarisë së Vetme të Thesarit.

Aktet baze të funksionimit të komunes janë:

Ligji për kufijte administrativ të komunave, nr 03/L-041

Ligji për financat e pushtetit lokal, nr 03/L-040

Statuti i Komunes së Podujeves, nr.01-020/01-0050862/18

Aktet tjera nenligjore

1.2 Pagesat nga palët e treta

Në zbatim të SNKSP 2017 pagesat nga palët e treta shpalosen në shënimin 13.

1.3 Shumat raportuese

Shumat raportuese nga neni:

13 deri te neni 15 janë në `000 (mijë) Euro (€),

16 deri te neni 24 shumat janë shuma e plotë Euro (€).

1.4 Valuta raportuese

Shumat janë raportuar në valutën Euro (€),

1.5 Data e autorizimit

Autorizohen me datën e nënshkrimit të deklaratës për Pasqyrat Financiare nga Zyrtari Kryesore Administrativë dhe Zyrtari Kryesore Financiar.

Neni 14.6

Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit

Ndryshimet e autorizuara nga LMFP										
Kategoria e ndarjes	Buxheti Fillestar (Ligji i Buxhetit)	Ndryshimi I	Ndryshimi II	Ndryshimi III	Ndryshimi IV	Të hyrat vetanake	Grantet e përcaktuara te donatoreve	Burime tjera te financimit	Buxheti përfundimtar SIMFK	Ndryshimet e buxhetit fillestar
	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000
Hyrtet										
Të hyrat tatimore	849					347			1,196	0.408716137
Të hyrat jo tatimore	1,011					1,364			2,375	1.349159248
Të hyrat e dedikuara									-	# DIV/OI
Grantet e përcaktuara të donatorëve							327		327	# DIV/OI
Huamartet									-	# DIV/OI
Klauzola për investime									225	# DIV/OI
Gjithsej	1,860	-	-	-	-	1,711	327	-	4,123	1.216666667
Daljet										
Paga dhe shlesa	16,518	1,669							18,187	0.101041288
Mallja dhe shërbime	3,586					32	7		3,625	0.010900725
Shpenzime komunale	513					40			553	0.0797271
Transfere dhe subvencione	1,670					153	421		2,244	0.343712575
Shpenzime kapitale	8,981					879	71		9,931	0.105778866
Rezerva										# DIV/OI
Kthimi i huamartjeve									-	# DIV/OI
Tierat									-	# DIV/OI
Gjithsej	31,268	1,669	0	0	0	1,104	499	0	34,540	10.5%

Shpalos në detaje shënimet në tabelë

Te pjesa e te hyrave nuk kemi pasur ndryshim ne planin e te hyrave vetanake , te hyrat direkte jane 347,163 euro, dhe te hyrat indirekte jane 1,363,731 euro.

Shuma e donacioneve 327,122.43. Te donacionet shuma 309,548 euro figuron te tabela e buxhetit ne sistem si te hyra nga donacionet, mirepo shuma 17,574 euro nuk figuron tek tabela e buxhetit per donacione sepse ky donacion nuk eshte alokuar dhe si i tille nuk figuron ne sistem si buxhet final per donacione.

Ndryshimi i buxhetit përfundimtar nga ai fillestar të kategorisë e pagave ka rrjedhë kështu: shuma prej 1,669,331 € mjete shtes me vendim të qeverisë –vendimi nr 03/239 i datës 24.12.2024.dhe shuma 0.89 € nga Council of Europe.

Te mallërat dhe shërbimet ndryshimi i buxhetit përfundimtar nga ai fillestar rrjedh si vijon: Te hyrave vetanake të bartura 32,085 €, si dhe 7,202 € nga donatorët

Te shpenzimet komunale kemi ndryshim të buxhetit fillestar nga ai përfundimtar për shumën 40,309 që janë të hyra vetanake të bartura.

Te kategorisë e subvencioneve buxheti fillestar ka qenë 1,670,000 €, nga donatorët 420,776 € si dhe nga të hyrat e bartura 152,430 €.

Te kategorisë e kapitaleve kemi këtë ndryshim buxhetor: Buxheti fillestar 8,756,231 €,nga të hyrat e bartura 878,983 €, nga donatorët 70,639 € si dhe klauzola për investime 225,450 euro.

Tatimi në të ardhurat personale	877	877	851	607
Penoja e punë	682	682	4	4
Antaresimi - Oda e infirmierëve të Kosovës	-	-	-	-
Antaresimi - Oda e mjekëve të Kosovës	-	-	-	-
Kontributi pensional - punëtor	786	786	730	586
Kontributi pensional punëdhënësi	786	786	730	586
Shëtesa e veçant për të zgjedhurit	42	42	-	-
Punëtorët me kontratë (jo në listën e pagave)	-	-	-	-
Shëtesa e performancës	-	-	-	-
Shëtesa për kushte specifike	-	-	-	-
Shëtesa për punën pa orar të paracaktuar	9	9	-	-
Shëtesa për vëllimin e punës	4	4	-	-
Shëtesa për nëpunësim e sistemit shëndetësor	15	15	-	-
Shëtesa funksionale për arsimin universitar	-	-	-	-
Shëtesa funksionale për shëndetësi	-	-	-	-
Kujdestaria, puna gjatë natës dhe puna jashtë orarit të punës	351	351	-	-
Funksionet shëtesë	-	-	-	-
Anetarët e shërbimit të jashtëm	-	-	-	-
Stafi i administratës që punon jashtë vendit	-	-	-	-
Funksionarët me kohë të pjesshme	-	-	-	-
Tatimi i ndaluar në të ardhura personale	-	-	-	-
Kontributi pensional-punëtor	-	-	-	-
Shëtesat tranzitore	9	9	-	-
Kontributi pensional-punëdhënësi	-	-	-	-
Vendimet e gjykatave	1,673	1,673	766	1,127
Paga dhe shëtesa	18,188	-	18,092	96
	-	-	-	1
	-	-	-	18,188
	-	-	-	-
	-	-	-	16,110
	-	-	-	13,450

Shpalos në detaje shënimet e pasqyruara në tabelë: Buxheti përfundimtar për paga 18,187,621 €, prej tyre të shpenzuara 18,187,621 dhe ate 18,091,621 € nga Granti Qeveritar ,nga të hyrat vetanake 96,000 €.
Pagesa përmes vendimeve gjyqësore janë 1,673,274 mjete nga granti qeveritar (Paga për shpërbim jubilar, për përcjellje në pension si dhe për shujta)

Shënimi 3
Mallra dhe
shërbime

Peshkrimi	Gjithsej						Buxheti		Ndryshimi Buxheti -		2023	2022
	Pagesat € '000	FH € '000	KI € '000	EZHM € '000	GQ € '000	THV € '000	THD € '000	CPD € '000	Final € '000	Pagesat € '000	€ '000	€ '000
Shpenzimet e tjera per udhetime zyrtare jashte vendit	3.06				3					9	11	
Shpenzimet e vogla para xhepi jashte vendit	-				-					2		
Akomodim perudhetime zyrtare jashte vendit	12.00				12					1	1	
Shpenzimet tjera te udhetimeve zyrtare jashte vendit	-				-					1		
Transporti per udhetime zyrtare brenda vendit	0.10				0							
Shpenzim per takime zyrtare brenda vendit	14.54				15							
Transporti per udhetime zyrtare jashte vendit	9.36				9							
Para xhepi/ medijet per udhetime zyrtare jashte vendit	4.46				4							
Shpenzimet postare	0.24				0					0	0	
Shërbimet e ndryshme shëndetësore	0.80				1					0	0	
Shërbimet keshilldhënëse dhe profesionale	117.73				118					53		
Shërbimet e veganta konsulent dhe kontraktore individual	1.88				2							
Shërbime shly pjes printimit	10.29				10					5		
Shërbime teknike	45.46				45					63		
Shërbimet kontraktuese te tjera sigurimi fizik l objekteve publike	413.72				401	12				621		
Shpenzimet e anetaresimit	28.74				24	5						
Shërbimet e telekomunikimit	15.00				15							
Shpenzimet per shërbime	-				-					-	10	
Mobiljet	-				-					-	864	
Kompiuteret	159.20				159					165	504	
Makinat fotokopjuese-multifunksionale	200.26				200					27		
Paisje tjera	0.98				1					-	-	
Paisjet speciale mjekësore	176.49				176					280		
Blerja e mobiljeve dhe paisjeve me pak se 1000 euro	7.20				7						464	
Blerja e librave dhe veprave artistike	-				-					-		
Paisjet sportive	39.17				39					21		
Paisjet shkencore kulturore	2.30				2						0	
Blerjet tjera te mallerave dhe shërbimeve	41.07				41					-	339	
Derivatet dhe lendet dëgese	-				-					-		
Furnizime per zyre	24.92				25					40		
Llogaritë e avansit	-				-					-	(3)	

Shpalos në detaje shënimet e pasqyruara në tabelë:

Buxheti perfundimtar per mallera dhe sherbime 3,624,788 €. Te shpenzuara 3,413,317 dhe ate 3,350,195 € nga Granti Qeveritar ; 63,122 € nga te hyrat vetanake.

Pagesat per vendime gjyqesore nga granti qeveritar jane 368,455 €. Nga granti qeveritar 342,123 euro dhe na te hyrat vetanake 26,332 euro.

Shënimi 4 Shpenzime komunale

2024													2023		2022	
Peshkrimi	Gjithsej							Buxheti		Ndryshimi Buxheti -		€ '000	€ '000			
	Pagesat	FH	KI	EZHM	GQ	THV	THD	CPD	Final	Pagesat						
	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000						
Energjia elektrike	402				387	14.7						356	320			
Shtetbimet e ujësjetilist dhe kanalizimit	81				69	12.37						56	55			
Albeturinat	29				29							44	29			
Ngrroja qendrone	-												10			
Telefonia fikse	7				7							10	6			
Pagesat -vendimet gjyqësore	28				15	13.24										
Pagesat sipas 39.2 te LMFP-gë	-															
Shpenzime komunale	548	-	-	-	508	40	-	-	553	5		466	420			

Shpalos në detaje shënimet e pasqyruara në tabelë:

Buxheti perfundimtar per shpenzime komunale 553,309 € , i shpenzuar 548,117 euro, 507,809 nga granti dhe 40,309 euro nga te hyrat vetanake. Pagesat me vendime gjyqesore 28,237 euro prej tyre 15,000 euro nga granti dhe 13,237 euro nga te hyrat vetanake,

Shënimi 5 Subvencione dhe transfere

2024

Pëshkrimi	Gjithsej										Buxheti		Ndryshimi		2023		2022	
	Pagesat € '000	FH € '000	KI € '000	FZHM € '000	GQ € '000	THV € '000	THD € '000	GPD € '000	Final € '000	Buxheti - Pagesat € '000	2023		2022		2023		2022	
Subvencione për entitetet publike	217	-	-	-	10	207	-	-	-	-	21	-	-	-	21	-	-	-
Subvencione për entitetet publike kulturore	1,758	-	-	-	795	686	277	-	-	-	1,249	-	938	-	1,249	-	938	-
Transferet për përfitues individual tërë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	210	-	224	-	210	-	224	-
Pensionet bazë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Pensionet bazë kontributuesë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0	-	-	-	0	-	-	-
Pensionet për personat me aftësi të kufizuar	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0	-	-	-	0	-	-	-
Pensionet e ndihmës sociale	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0	-	-	-	0	-	-	-
Pensionet për të burgosurit	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0	-	-	-	0	-	-	-
Pensionet për veteranët e luftës	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0	-	-	-	0	-	-	-
Pensionet për të verbërit	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0	-	-	-	0	-	-	-
Pensionet e TMK-së	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0	-	-	-	0	-	-	-
Pensionet e FSK-së	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0	-	-	-	0	-	-	-
Pensionet familjar	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0	-	-	-	0	-	-	-
Pagesat për familjet e të rënëve në luftë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0	-	-	-	0	-	-	-
Pensionet e përkoreshme të Trepës	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0	-	-	-	0	-	-	-
Lehonat e punësuar	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0	-	-	-	0	-	-	-
Vendimet gjyqësore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0	-	-	-	0	-	-	-
Pagesat për sektorin e blegtorisë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	74.64	-	109.524	-	74.64	-	109.524	-
Pagesat për kulturat bujqësore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0	-	-	-	0	-	-	-
Shtu kod sipas nevojës	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0	-	-	-	0	-	-	-
Subvencione dhe transfere	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0	-	-	-	0	-	-	-
	1,975	-	-	-	805	893	277	-	2,243	268	1,554	-	1,272	-	1,554	-	1,272	-

Buxheti perfundimtar per subvencione dhe transfere eshte 2,243,206 €. Te shpenzuara 1,975,2396 € dhe ate 804,969 € nga granti, 893,092 € nga te hyrat vetanake si dhe 277,177 € nga donatoret.

Shënimi 6 Shpenzime kapitale

Transfer kapitale-entitet jpublike	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Nërtim i auto rrugëve	-	-	-	-	-	-	-	140	3,238
Nërtim i rrugëve lokale	-	-	-	-	-	-	-	2,668	-
Triduar	-	-	-	-	-	-	-	517	442
Marrëdhënia e investimeve	-	-	-	-	-	-	-	260	133
Rrjetet e kanalizimit	622	467	477	99	-	-	-	552	383
Rrugët lokale	2,895	-	2,895	-	-	-	-	-	-
Triduar	180	-	180	-	-	-	-	-	-
Rrjetet e ujësjellësit	132	-	132	-	-	-	-	-	116
Rrjetet mjekësore	80	-	80	-	-	-	-	-	-
Rregullimi i lumenjve	-	-	-	-	-	-	-	350	162
Shtirërit e lumenjve	467	-	467	-	-	-	-	-	85
Furnime nryngjerrimitransmis	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Mekina fadkapijuse	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Pajisje të teknologjis inform	-	-	-	-	-	-	-	184	-
Bashkëfinancim me IPA	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Pajisje tjera	-	-	-	-	-	-	-	-	89
Parrjet dhe hapësirat publike	183	-	183	-	-	-	-	-	25
Vetura të ndihmes së sipërje	-	-	-	-	-	-	-	149	-
Vetura zyrtare	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Softuer	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Parrjet dhe hapësirat publike	72	-	-	72	-	-	-	-	-
Karton	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Pagesat sipas vendimeve gjyqësore	1,792	-	1,178	613	-	-	-	222	557
Pagesa sipas nenit 39.2. LMFP	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzime kapitale	9,315	47	-	-	7,873	1,394	-	9,931	617
								8,468	7,183

Buxheti perfundimtar per investime kapitale eshte 9,931,301 €. Jane shpenzuar 9,314,637 €. Nga granti 7,873,438 €, nga te hyrat vetanake 1,394,478 €, dhe nga financimi per huamarije per klauzolenper investime 46,720 euro.

